Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / www.kmsh.al

DRITA ISLAME

Të gjithë kemi nevojë

PËR MËSHIRËN E TIJ

ISSN 2226-7115
01
9 772226 711008

Viti XXIX / Nr. 1 / Janar 2020 / Çmimi: 150 Lekë / www.dritaislame.al

BOTIMET KMSH

MUND T'I GJENI PRANË LIBRARISË MIQTË E LIBRIT

Doli nga shtypi botimi i fundit i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me titull: "Tefsiri i sureve të shkurtra të Kuranit", përmbledhur nga Këshilli Botues pranë KMSH-së.
Në këtë libër të vogël tefsiri janë përmbledhur disa interpretime të dijetarëve të shquar, që fillojnë me suren Fatiha, pastaj me suren Duha dhe me radhë deri te surja Nas, pra gjithsej 23 sure.

BOTIM I RI



TEFSIRI

I SUREVE TË SHKURTRA **TË KURANIT**

"DRITA ISLAME" FYTYRA E MYSLIMANËVE SHQIPTARË

Një njeri mbi të gjitha, kujdeset për fytyrën e tij, atë pjesë të trupit që e ndan nga të tjerat dhe e indentifikon. Njihet kujdesi për flokët, për petkat që veshim, por e dimë që mbi të gjitha sa ngrejmë kokën nga jastëku, shkojmë e rregullojmë fytyrën tonë në pasqyrë. Ajo do të na ndjekë gjithë ditën, e ditën e tjetër e më tej dhe të gjithë do të na vlerësojnë sipas saj.

"Drita islame" është fytyra e myslimanëve shqiptarë, është karta e identitetit me të cilën çdokush na njeh e na vlerëson. Është një pjesë e jona, pa të cilën do ishim një turmë pa fytyrë, pa shprehje dhe rrjedhimisht e pakuptuar nga të tjerët. Jo vetëm kaq, por myslimanët shqiptarë do ishin, pse jo, të keqkuptuar dhe të keqinterpretuar, sepse nuk do dinin ta shpjegonin qëllimin e tyre, jetesën e tyre, ato gjëra që ata i quajnë të shenjta dhe mundohen t'i montojnë në ingranazhin e ditëve që na janë dhënë për t'i vënë në përdorim.

Myslimanët shqiptarë, në këto kohë kur imazhi i Islamit është bërë një top futbolli në këmbët e 'futbollistëve' të këqij, që kanë dalë prej vetë radhëve tona, duhet të thonë zërin e tyre që t'i dëgjojnë të gjithë. Ta ndajnë shapin nga sheqeri. Kjo bëhet nëpërmjet këtyre rreshtave, dhe askush s'do të na keqkuptonte. Askush nuk do ngrihej e të na identifikonte me ata pseudo-myslimanë që Islamin e kanë bërë copë me bajonetat e kallashnikovëve me të cilët shfaqen në ekranet e rrjeteve më të mëdha televizive në botë.

"Drita islame" vjen me dëshirën për të hyrë në shtëpinë e çdo myslimani, e pse jo të çdo shqiptari, që do të mësojë sadopak për myslimanët, jetën dhe vizionin e tyre.

"Drita islame" sigurisht që ka përpara sfida të mëdha, por, mbi të gjitha, një qëllim të madh: të hyjë në çdo shtëpi myslimani, të bëhet pjesë e pandarë e jetës dhe e familjes së tij. Këtu fillon edhe detyra juaj motra e vëllezër myslimanë, përgjegjësia që ju ka ngarkuar Zoti për ta përçuar fjalën e Tij tek të gjithë njerëzit rrotull jush. Kjo është detyra e të gjithëve ne. Allahu na ndihmoftë në këtë rrugë.

Na ndiqni edhe në

www.dritaislame.al

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Mehmet Disha
Detin Kotrri

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Hysen Vogli

KONTAKT:
Për abonime 067 29 47 096
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

Viti XXIX i botimit
Nr. 1 (444)
Janar, 2020

ISSN 2226-7115

Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

5 Të gjithë kemi nevojë për mëshirën e Tij / Dorian Demetja
8 Fjalët e Tërmetit / Qani Sulku
10 Lajme / Aktivitete

14 Mos e shpërfill këshillën e mirë / Nuredin Nazarko
16 Nga blloku i shënimeve të shkrimtarit / Hysen Kobellari
18 Feja në aspektin edukativ, në besimin te Zoti II / Xhemal Balla
22 Ndjeshmëria e sahabeve në të shprehur / Taulant Bica
24 Devocioni dhe dinjiteti, - ky është sekreti ! …
28 Emri i Zotit ''Allah ''
30 Foto e muajit
32 Imam Gazaliu për debatin / Haki Sahitaj
36 Mos u trishto!
38 Nga kush kërkoni ndihmë gjatë sprovave? / Jasmin Muxhahid
40 Hafiz Qamil Tresi, tetovari që lidhi emrin e tij me Shkodrën
44 Thënie të Othmanit r.a.
46 Fakte interesante rreth trupit të njeriut
48 Një martesë e shëndetshme, një investim i çmuar / Aisa Kokiçi
52 Rregullatori i personalizuar i temperaturës
56 Dhurata e sinqertë

| DORIAN DEMETJA |

TË GJITHË KEMI NEVOJË PËR MËSHIRËN E TIJ

Falënderime të panumërta i qofshin Zotit që në mesin e njerëzve na ndriçoi me besim. Me anë të këtij besimi ndryshuan jetët tona, si dhe konceptet për mënyrën se si duhet t'i shohim dhe gjykojmë fenomenet e ndryshme. Por besimi nëse nuk mirëmbahet, ashtu si çdo gjë, vjetërsohet dhe, Zoti na ruajtë, rrezikon të humbasë. Që ky besim të mbahet i gjallë, që të rifreskohet, të rinovohet apo të forcohet më tej, ka nevojë për ushqim shpirtëror, për adhurim, punë të mira dhe lutje të ndryshme drejtuar Krijuesit.

Njeriu, krijesa më me vlerë, më e vyer dhe më e bukur e Allahut (xh.xh.) në rruzullin tokësor, është po aq gjynahqare. Nuk mund të jetë ndryshe kur mëkati është pjesë e jetës së njeriut. Pikërisht kjo e bën njeriun, njeri dhe jo engjëll. Në një hadith kudsi, i Madhi Zot shprehet kështu: "Nëse ju do të ishit popull që nuk gabon, Unë do ju fshija nga sipërfaqja e dheut e do të krijoja njerëz që gabojnë. Në mënyrë që t'më njihnit Mua si të Mëshirshëm".

Mirëpo për besimtarin, gjynahet kanë peshë të rënda, të cilat bëhen pengesë në rrugën drejt Zotit. Sepse pas dhuratës më të madhe, që është besimi, Zoti na urdhëron të thellohemi në besim. Njeriu hyn në gjynahe me dashje apo pa dashje, ndonjëherë edhe si kupton gjynahet e vogla. Për këtë arsye, Allahu me Madhështinë e Vet, ka krijuar shumë mundësi dhe sebepe për njeriun (si abdesi, namazi, Kurani, sadakaja, sjellja e mirë etj.) që nëpërmjet tyre t'i falen gjynahet dhe të fitojë mëshirën e Krijuesit. Profeti (a.s.) thotë se vetëm me mëshirën e Zotit hyjmë në xhenet. I thanë shokët: Edhe ti o i dërguari i Allahut? Po ju përgjigj ai. Edhe unë.

Allahu kërkon nga ne besimtarët që dita ditës të përmirësojmë diçka nga vetet tona, të përkushtohemi më shumë, të ecim drejt hapave të devotshmërisë. Ai (xh.sh.) na mëson që gjynahet presin lidhjen që kemi me Të. Për këtë arsye, mbështetur edhe në jetën e vetë Profetit (a.s.) duhet të pendohemi shumë dhe të vazhdojmë rrugën drejt Zotit, duke qëndruar larg gjynaheve. Mirëpo ka njerëz, të cilët nuk po i shmangen disa gjynaheve apo veseve të këqija, megjithëse përpiqen. Ata kërkojnë përgjigje, kërkojnë qetësi, ngushëllim apo forcë në përballjen e situatave të pakëndshme që u kanë trazuar shpirtin. Dhe shejtani, që është armiku i vërtetë i njeriut, kënaqet kur e sulmon atë nga dobësitë që ka. Por kënaqësi më e madhe për shejtanin është kur besimtarin e bën të dorëzohet, kur e bën pesimist derisa ai të marrë rrugën e qoftëlargut. Prandaj gjithmonë duhet t'i kthehemi Allahut, sepse dera e pendimit është e hapur për të gjithë

ata, që shpresojnë tek falja e Zotit (xh.sh). Hz. Vahshiu, i cili kishte bërë një punë të shëmtuar duke u bërë vrasësi i xhaxhait të Profetit, hz. Hamzait, kërkonte një drite shprese dhe shpëtimi. Ai i dërgon një letër Profetit (a.s.), ku i thotë: "O profet i Zotit! Unë dua të pendohem por ia kam frikën një ajeti në Kuran, ku thotë se ai që i ka vënë shok Allahut (xh.sh.), që ka bërë imoralitet dhe që ka vrarë tjetrin pa të drejtë, do ta marrë dënimin e tij. Unë kam vrarë Hamzain, kam bërë imoralitet dhe i kam vënë shok Allahut (xh.sh.), prandaj kam frikë se Zoti nuk m'i fal gjynahet". Atëherë, i dërguari i Zotit i shkruan në letrën e dërguar, ajetin kuranor ku thotë: "**Përveç atij që është penduar, beson dhe bën vepra të mira, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu**[1]**".është Falës e Mëshirëplotë**

Vahshiu në vazhdim tha: "Allahu (xh.sh.) ka vënë kusht që të bëjmë punë të mira, mirëpo unë nuk bëj punë të mira, prandaj kam frikë se Zoti nuk do të më falë". Atëherë Profeti i dërgon ajetin: "**Thuaj: O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Pa dyshim, Allahu i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.**"[2], ku i tregon gjerësinë dhe pafundësinë e mëshirës së Krijuesit për të gjithë mëkatarët dhe është bërë një dritë shprese për të gjithë ata që nuk gjejnë asnjë mundësi shpëtimi në jetën e tyre. Pika më e fortë në të cilën mbështetet njeriu, drejtimi më i saktë ku ai orientohet, është mëshira e Allahut. Asnjëherë njeriu nuk i pret shpresat nga kjo mëshirë. Ai beson në mënyrë të prerë se cilido qoftë gjynahu që ka bërë, çfarëdolloj padrejtësie të ketë kryer, dera e faljes dhe e mëshirës së Allahut është gjithmonë e hapur, mjafton që njeriu të trokasë e të kërkojë falje nga Ai. Me mëshirën e Allahut do të kalojmë me sukses këtë jetë, me mëshirën e Tij do të kalojmë pa vështirësi llogarinë për veprat tona, me mëshirën e Tij do të kalojmë me lehtësi inshaAllah urën e siratit, si dhe me mëshirën e Tij do të trokasim në dyert e xhenetit. Në një hadith kudsi, Zoti i Lartmadhëruar thotë: "O bir i Ademit! Përderisa t'më drejtohesh Mua e t'më lutesh Mua, çfarëdolloj mëkati të bësh unë do të ta fal. O bir i Ademit! Edhe sikur mëkatet e tua të arrijnë kufijtë e qiellit, Unë përsëri do të t'i fal ato. O bir i Ademit! Nëse më vjen me mëkate sa e gjithë dynjaja, pa më bërë shirk, do të t'i fal të gjitha ato."

Krijuesi ynë kërkon prej nesh një pendim të sinqertë, kërkon vetëm një lëvizje zemre dhe në atë moment do ta gjejmë pranë Allahun (xh.sh). Prandaj vazhdimisht dhe për çdo gabim, të pendohemi te Zoti, t'i japim fjalën për të mos u kthyer më në ato gjynahe që kemi bërë, si dhe të kërkojmë me sinqeritet të plotë mëshirën dhe faljen e Tij të pafund. Kjo është mëshira e Zotit prej së cilës nuk pritet asnjëherë shpresa. Në këtë drejtim, i dërguari i Allahut (a.s.) në njërën prej perlave të tij na tregon kështu: *"Allahu shtrin dorën e Tij natën që të pendohet kush bën mëkate ditën, dhe shtrin dorën e Tij ditën që të pendohet kush bën mëkate natën, derisa dielli të lindë andej nga perëndon"*.[3]

Dorian Demetja
Drejtor i Kulturës dhe Arsimit, KMSH

1. Furkan 25:70

2. Zumer, 39:53

3. Muslim



“ËSHTË E MAHNITSHME ÇËSHTJA E BESIMTARIT, SEPSE ÇDO GJË PËR TË ËSHTË E MIRË DHE KJO VETËM PËR BESIMTARIN DHE PËR ASKËND TJETËR. NË QOFTË SE ATË E GODET NDONJË E MIRË, AI FALËNDERON ZOTIN PËR TË DHE KJO ËSHTË MIRË. POR, EDHE NË QOFTË SE ATË E GODET NDONJË FATKEQËSI, AI DURON DHE PËRSËRI KJO ËSHTË MIRË PËR TË.”

PROFETI MUHAMED





FJALËT E TËRMETIT

Çdo gjë që na ndodh në jetë, qoftë mirësi apo fatkeqësi, nuk ndodh rastësisht dhe pa qëllim. Allahu i Lartësuar zgjedh mënyra të ndryshme për t'ia përcjell mesazhet e Tij njerëzve. Një ndër to janë edhe tërmetet, si ato të ditëve të fundit të nëntorit 2019 që erdhën për të na shkundur shpirtërisht përpara se të dridhnin trupat tanë dhe ndërtesat ku ne jetojmë. Tërmeti erdhi për t'na thënë se i vetmi me fuqi mbinatyrore është Allahu, të Cilit i mjafton t'i thotë diçkaje "Bëhu" dhe ajo bëhet në çast. Është Ai që urdhëroi tokën të dridhej për pak sekonda dhe u vu re se çfarë pasojash shkaktoi ajo dridhje dhe lëkundje në jetë njerëzore dhe në banesa. Po të donte Ai, (Allahu), mund ta zgjaste dridhjen me minuta, me orë, me ditë, duke e shfarosur popullsinë e duke e bërë të pabanueshme tokën. Për Të, asgjë nuk është e pamundur dhe e vështirë. Tërmeti dhe paslëkundjet që e shoqëruan, instaluan në brendinë tonë frikën dhe ankthin për ditë dhe javë të tëra. Gjumin s'e bënim rehat, duke menduar nëse do zgjohemi gjallë apo jo; rrinim me frikë në shtëpitë tona, me idenë se nga momenti në moment, toka mund të dridhej sërish e gjithçka mund të na zinte poshtë. Rrinim në gatishmëri totale për të lënë banesat, sa herë kishte dridhje, madje deri aty na kishte hyrë frika në palcë, saqë edhe kur nuk dridhej toka, neve na dukej sikur dridhej. Zgjodhëm që disa netë t'i kalonim nëpër makina dhe në ambiente të hapura larg ndërtesave, për t'u ndier më të sigurt dhe më të mbrojtur. Disa ditë bashkëjetuam me frikën e tërmeteve dhe na dukej jeta një torturë e vërtetë. Na iku oreksi për të ngrënë dhe për të bërë një jetë normale. Ndryshoi monotonia e përditshmërisë sonë për disa ditë dhe shija e jetës ishte e hidhur. Kudo flitej vetëm për tërmet, për rrezikun që na kanoste. E gjithë kjo na tregon se sa e çmuar është siguria dhe stabiliteti.

Të shumta dhe të ndryshme janë arsyet se pse goditen njerëzit nga tërmetet, gjithmonë sipas këndvështrimit islam. Ndodh që tërmetet të bien si dënim për mëkatet e njerëzve; ndodh që të bien për t'i zgjuar njerëzit nga gjumi i thellë i shkujdesjes dhe neglizhencës ndaj përkujtimit të Allahut të Lartësuar. Ajo që është e sigurt dhe që s'ka diskutim në të, është fakti se asgjë nuk ndodh pa urdhërin e Zotit të Plotpushtetshëm, as edhe rënia e gjethes nga pema nuk ndodh pa lejen e Tij.

Tërmeti erdhi për t'na thënë sesa të dobët jemi ne karshi përcaktimit të Allahut, përcaktim ndaj të cilit dorëzohemi me dëshirë apo me pahir, pasi nuk kemi forcë për ta ndryshuar. Tërmeti erdhi për t'na thënë se nuk ka vlerë asnjë pasuri e kësaj bote përpara jetës që na e ka dhuruar i Madhi Zot. Edhe njerëzit më të kamur financiarisht, braktisën vilat e tyre shumëkatëshe dhe luksin ku jetonin dhe as që e menduan dy herë se ç'farë dëmi do kishin pasuritë e tyre, u mjaftonte të shpëtonin veten dhe familjarët e tyre. Tërmeti erdhi dhe iku duke marr me vete edhe dhjetëra jetë njerëzish për t'u shndërruar kështu në shembull reflektimi për ata që mbetën pas, se vdekja ishte shumë pranë tyre, dhe po të donte Allahu, mund të kishin të njëjtin fat si ata që ikën për të mos u kthyer më. Tërmeti erdhi për t'na thënë se sot jemi mbi tokë, por mund të ndodhë që edhe sot të jemi banorë të pajetë të nëntokës. Tërmeti erdhi për t'ia përplasur në fytyrë mosmirënjohjen të gjithë atyre që nuk janë falënderues ndaj Allahut për gjithçka posedojnë, i Cili po të donte ua asgjësonte dhe ua bënte hi e pluhur.

Njeriu duhet të nxjerr mësime nga ajo çfarë përjeton dhe të reflektojë mbi shkaqet që mund të kenë çuar në zbritjen e fatkeqësive në jetën e tij dhe rolin që ai ka në raport me veten, njerëzit që e rrethojnë, e mbi të gjitha raportin e tij me Zotin. Kur zbret dënimi i Allahut, ai prek edhe të thatin edhe të njomin; edhe mëkatarin e rënduar me gjynahe, edhe besimtarin që mundohet të mbrohet prej tyre. Në Kuran rrëfehen historitë e popujve, të cilët Allahu i shkatërroi nëpërmjet tërmeteve, tufaneve, përmbytjeve... për shkak se nuk iu përgjigjën thirrjes së Tij dhe bënë trazira në tokë. Gjithashtu, në historinë islame gjejmë rastin e popullit, ku një njeri ishte bërë sebeb për të mos zbritur shi mbi tokë dhe për të mbizotëruar një thatësirë e madhe, derisa ai u pendua përulësisht për mëkatet e tij dhe Allahu e pranoi kërkim-faljen e tij duke zbritur shiun si mëshirë për këtë popull. Duke marrë shkas nga këto shembuj, mund të themi lirisht se tërmeti erdhi për t'na thënë se duhet të pendohemi sa më parë për çdo mëkat që kemi bërë, për çdo zullum e padrejtësi që kemi shkaktuar dhe të bëjmë kthesë të madhe në jetën tonë; t'i kthehemi Allahut dhe udhëzimeve të Tij në Kuran dhe këshillave profetike, të cilat duhet të na shërbejnë si udhërrëfyes në jetë. Vetëm kështu mund ta fitojmë kënaqësinë e Allahut. Le të jetë pikërisht qëllimi ynë ky synim: arritja e kënaqësisë së Allahut, sepse Ai nuk e dënon atë popull prej të cilit është i kënaqur. O Zot! Na bëj prej tyre e mos na dëno për shkak të mëkateve tona, sepse ne jemi gjynahqarë ndërsa Ti je Falës, e do faljen, na fal neve! Amin!

1 INAGURIMI I XHAMISË NË FSHATIN SHIRQ

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, sëbashku me Myftiun e Shkodrës, z. Muhamed Sytari, Ambasadorin e Kuvajtit, Sh.T.Z. Fayez Mishari Al-Jasim, Kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, Drejtorin e Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, si dhe donatorët, kontribuesit dhe besimtarë të shumtë të zonës hapën dyert e xhamisë së re të fshatit Shirq në Shkodër. Kjo xhami u ndërtua falë kontributit të familjes së nderuar të Dr. Nebil Abdurrahim nga Kuvajti.

2 INAGURIMI I XHAMISË NË MAT

Në fshatin Suç të Myftinisë Mat u zhvillua ceremonia e inaugurimit të xhamisë së re të këtij fshati.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Drejtori i Arsimit dhe Kulturës pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Dorian Demetja, Myftiu i Matit, z. Fabjon Kolaveri, Myftiu i Dibrës, z. Muis Kurtulla, Drejtori i Shoqatës "Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi", z. Ibrahim Mekki, dijetari dhe humanisti i njohur nga Kuvajti, z. Nebil el Auadi, si dhe donatorët, kontribuuesit dhe besimtarë të shumtë të fshatit Suç të rrethit Mat.

Kjo xhami u ndërtua falë kontributit të shoqatës "Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi".



3 DELEGACIONIN E UNIONEVE TË BASHKËSIVE ISLAME SHQIPTARE NË ZVICËR, GJERMANI, AUSTRI DHE ITALI

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, Delegacionin e Unioneve të Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër, Gjermani, Austri dhe Itali.

Ky delegacion gjendet prej disa ditësh në Shqipëri, ku sëbashku me përfaqësues të KMSH-së kanë vizituar nga afër zonat e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit dhe në koordinim me këta të fundit, do të vlerësojnë dhënien e kontributeve të mbledhura nga thirrjet në xhamitë respektive.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre vazhdoi më tej me diskutimin e bashkëpunimeve të tjera të mundshme në të ardhmen.

Në fund të takimit, Kryetari i KMSH-së, u dorëzoi të pranishmëve disa certifikata mirënjohjeje dhe vlerësimi për kontributet e ndryshme të dhëna deri më tani nga këta bashkësi Islame.

4 ROLI I FEVE NE PROMOVIMIN E TOLERANCËS

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu i shoqëruar nga Kancelari i Institucionit, z. Ylli Cikalleshi dhe Këshilltari për Marrëdhëniet me Botën Arabe, z. Xhemal Saferti, morën pjesë në konferencën tre ditore të organizuar nga Forumi për Konsolidimin e Paqes në Shoqëritë Myslimane, me temë: "Roli i Feve në Promovimin e Tolerancës: Nga mundësia në domosdoshmëri ".

Kjo konferencë, e cila zhvillohet nën kujdesin e Ministrit të Jashtëm dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të EBA, z. Abdullah bin Zayed al-Nihjan, mblodhi sëbashku personalitete, udhëheqës fetarë dhe politik, dijetarë, studiues dhe akademikë të feve të ndryshme nga e gjithë bota për të diskutuar mbi rolin e besimeve fetare në promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës.

5 TAKIMI ME MYFTINJTË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi në selinë e institucionit një takim pune me të gjithë myftinjtë e rretheve të vendit. Takimi u mbajt më datë 16 Dhjetor 2019.

Ky takim vjen si nevojë e diskutimit të mënyrës së menaxhimit të ndihmave që çdo myftini ka mbledhur me anë të thirrjeve në xhamitë përkatëse dhe fondeve të ardhura nga burime të tjera për familjet e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu falënderoi të gjithë myftinjtë për angazhimin, kontributin dhe mbledhjen e fondeve monetare dhe materiale për familjet e lartë përmendura. Më tej ai u ndal në angazhimin dhe sensibilizimin e të gjithë besimtarëve dhe qytetarëve të cilët kontribuan në forma të ndryshme.

6 TAKIMI I KRERËVE FETARE ME PRESIDENTIN

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në takimin e organizuar nga Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, me krerët e komuniteteve fetare në Shqipëri, ku u diskutua mbi situatën e pas tërmetit të 26 nëntorit dhe pasojat jo vetëm materiale, por dhe shpirtërore të qytetarëve në zonat e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore.

Kryetari Spahiu, gjatë takimit tha se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është sensibilizuar menjëherë pas tërmetit në koordinim me Myftinitë, Universitetin Bedër, Medresetë dhe organet e tjera shtetërore për t'ju ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga tërmeti.

Gjithashtu KMSH me anë të strukturave të tij ka organizuar programe këshilluese psikologjike, është angazhuar në shpërndarjen e ndihmave, ka shërbyer në mënyrë vullnetare në terren, ka bërë thirrje për ndihma monetare në të gjithë xhamitë e vendit dhe ka bashkëpunuar me bashkësitë fetare Islame të rajonit, diasporës e më gjerë.

Presidenti Meta, i falënderoi krerët e bashkësive fetare për reagimin e tyre të menjëhershëm, duke u gjendur pranë njerëzve në këto momente të vështira dhe vlerësoi mbështetjen e tyre të pazëvendësueshme materiale, shpirtërore, morale dhe psikologjike.

7 INAGUROHET XHAMIA E HADMIT

Nën një atmosferë të ngrohtë shpirtërore, me lexim Kur'ani, ilahi dhe përshëndetje të ndryshme nga të ftuarit e nderit, më datë 27 Dhjetor 2019, u hapën dyert e xhamisë së "Hadmit" në fshatin Pezë e Vogël, Tiranë.

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, përgjegjësi i çështjeve fetare pranë Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Hamd el-Saj'arij, si dhe dhjetëra besimtarë të këtij fshati.

Restaurimi i kësaj xhamie u bë falë kontributit të Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite në bashkëpunim me Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, ndërsa projekti i restaurimit të saj u implementua nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

| NUREDIN NAZARKO |

Mos e shpërfill këshillën e mirë

Në ditët e sotme është rritur ndjeshëm numri i këshilldhënësve. Të japësh këshilla në ditët e sotme është gjëja më e lehtë, më e thjeshtë. Mjafton që të kesh një pyetje, një shqetësim, një problem dhe nuk do të vonojnë të ngjiten në skenë këshilluesit se si duhet vepruar për të gjetur derman. Secili sipas formimit dhe bindjeve personale flet si autoritativ, duke dashur të dëshmojë se nuk flet më kot, se qëllimi i tij është vetëm e vetëm të shpëtojë hallexhiun nga barra që i ka rënë mbi shpinë.

Sekush me filozofinë e shkollës së jetës hedh në treg këshillat e tij apo të saj. Tekefundit kemi edhe tregun e këshillave, ashtu siç po tregëtarizohet çdo pore e jetës, duke tharë edhe atë pak mistikë që mund të ketë shpëtuar në ndonjë cep të shpirtit. Është epoka e lirisë pa kufi, ku natyrisht teknologjia ka shpërthyer revolucionin këshilldhënës nga cilidolloj drejtimi.

Nuk kemi pse të marrim kot, të çakërdisim nervat me një mijë e një këshillat që vijnë nga çdo anë e këtij tregu, ku ka tregëtarë me shumicë. Është i vetmi treg që nuk shet me pakicë, edhe kur blerësit nuk i nevojitet asgjë më shumë sesa një fjalë a një vështrim i ëmbël, një buzëqeshje apo një begenisje e thjeshtë dhe pa shumë lustra nga pas.

Nëse ndokush mendon se ka për detyrë ta zhbëjë këtë treg, bujrum. Le të marrë detyrën dhe të nisë nga puna. Nuk besoj të ketë punë më të lehtë në botë se kjo. Mjafton të hysh në mes të tregut, të lëshosh disa klithma dhe krejt pa kuptuar do ta shohësh veten jashtë tregut me rroba të rreckosura e të gjakosura. Mendarët këshilldhënës nuk mund ta durojnë ndokënd që kërkon t'u nxijë me kongjij të shuar bardhësinë e pëlhurave, ku qëndrojnë të qëndisura me fije ari këshillat e tyre zgjidhjedhënëse.

Tregu është treg. Në tregun e konkurrencës së lirë nuk mund t'i imponohesh tregut. Nëse do të jesh pjesë e tregut, atëherë duhet t'i përshtatesh shijeve të klientëve dhe duhet t'u bësh temena që të blejnë këshillat e tua. Nëse nuk ua zbukuron mallin që kërkon të shesësh, nëse nuk u mbush mendjen se ky është mall krejt i veçantë, i stiluar me ornamente nga të katër cepat e botës, i qëndisur me fije ari, punuar me mjeshtëri mbi pëlhurë mëndafshi, zor se do të të besojnë. Nëse ua paraqet të vërtetën lakuriq, pa ndonjë makijazh që u pëlqen klientëve, atëherë jo vetëm që nuk do të qasen, por as sytë nuk kanë për të t'i hedhur. Shpejt do ta kuptosh se as lutjet për të marrë sadopak prej pëlhurave të tua zbukuruar me të vërtetën lakuriqe nuk bëjnë fajde. Zëri yt, edhe pse kumbues, mbytet shpejt nga zhaurima e zërave të dhjetra, qindra e mijra tregëtarëve që bërtasin me të madhe për të reklamuar cilësitë e rralla të antikuarëve të tyre. Je i detyruar të tërhiqesh, të mbledhësh ato pak pëlhura që ke dhe të shëtisësh nëpër botë, me shpresën se ndokund do të gjendet ndokush të kuptojë vlerën e asaj që t'i nuk ke kurrë ndërmend ta shesësh, por thjesht ta sjellësh në vëmendjen e atyre që janë thithur tërësisht apo gati tërësisht nga gjallëria e tregut zulmëmadh.

Dikush mund të mendojë se zëri kumbues do të mund të çajë ajrin e rënduar nga fryma e qindra e mijra tregëtarëve dhe blerësve dhe të mbërrijë në veshët e lodhur nga zhurmat e përditshme të tregut që i mban dyert hapur 24 në 24. Besimi i tepruar në vetvete bën që fillimisht të duket se po ia del bukur mirë të rezistojë. Tek – tuk ka ndonjë që kthen kokën, por vetëm kaq. Shpejt do ta kuptojë se shpërfillja është më e rëndë se pëlhurat që kërkon të ekspozojë. Në fund të ditës, javës apo muajit do ta kuptojë se ka vetëm dy rrugë. Ose do ta braktisë këtë treg, ku i vetmi qëllim mbetet maksimizimi i fitimit pa pyetur si e qysh, rritja artificiale e famës së tregëtarit përmes fjalëve shkëlqyese që di të përdorë në reklamimin e pëlhurave të tij, ose do të fillojë të marrë ngjyrat e tregut për të mos qënë i shpërfillur. Se çfarë do të vendosë, kjo varet nga qëllimi. A vazhdon ende të dashurojë të vërtetën lakuriqe që zbukuron pëlhurat e tij, apo në zemrën e tij ka lëshuar rrënjë dashuria ndaj zbukurimeve vezulluese të pëlhurave të mëndafshta që tregëtohen çdo ditë 24 në 24 në këtë treg zulmëmadh?

Këtë e vendos vetë ai që dëshiron të zhbëjë tregun. Por kujdes o zhbërës tregjesh, se ose do ta gjesh veten të falimentuar në këtë treg e mund të të njollosin vlerën e pëlhurave të tua, ose do t'i hedhësh vetë pëlhurat e tua e do të fillosh të tregëtosh sipas modelit të tregut që më herët e shihje si rival që duhej hedhur knockout.

Tregu vazhdon të ziejë siç ka qënë ngaherë. Kushdo që ka hyrë për të mbetur aty, aty ka mbetur. Kushdo që ka hyrë për të dalë, ka dalë. Kushdo që ka dashur të ruajë pëlhurat e zbukuruara me të vërtetën lakuriqe e ka gjetur rrugën për të ruajtur të pacënuar vlerën e tyre, paçka se pakkush mund t'ua njohë vlerën. Qëllimi është ruajtja, pacënueshmëria e vlerës dhe jo lavdet e zhdukshme njerëzore.



Nga blloku i shënimeve TË SHKRIMTARIT.

Bismil-lahi ... !
(Në emër të Zotit ... !)
Ja panda mazi ! ...
(Përgjithmonë bashkë !)

Kjo që do t'ju tregoj duhet të ketë ndodhur në kapërcyell të dy shekujve; aty midis shekullit të vjetër që ngarkon e shkon dhe të riut, që vjen e sundon...

Të mençurit thonë se në kapërcyell të dy shekujve, si në çdo ndërrim të tillë të rëndësishëm vendesh, mund të ndodhin ngjarje të mëdha, të cilat ndonjëherë mund të shfaqen me zhurmë e bujë, apo mund edhe të kalojnë në heshtje e pa u vënë re përkohësisht nga të tjerët. Por nuk ka dyshim se të tilla gjëra lënë tek njeriu gjurmë të pashlyeshme. Gjurmë, të cilat kujtesa, kjo mrekulli e Krijuesit, i rizbulon dhe i përtërin kur vjen dita, si të kishin ndodhur dje...

Njeriut i pëlqen të jetojë, të gjendet shpesh në mjedise të vërteta intelektuale, të cilat e plotësojnë, e ngopin shpirtërisht atë. Mjedise të tilla janë dhe mund të bëhen familja, shkolla, puna, shoqëria... Në një mjedis të tillë u ndodha një ditë, teksa isha pjesmarrës në një promovim libri me përkthime poetike. Përballë meje kisha një mesoburrë me një fytyrë të hijshme e të qeshur, me sy të gjallë e mjaft shprehës. Më tërhoqi vëmendjen qëndrimi i tij i heshtur dhe lëvizja e shpeshtë e gishtave të dorës së djathtë, midis të cilëve dalloheshin qartë gurët e praruar të një palë tespiesh të vogla. Burri diçka përshpëriste nëpër dhëmbë. Me siguri, lutej. Dukej që ai ishte i huaj; të paktën mua më dukej se ai nuk kishte qënë më parë banor i qytetit tim, përndryshe do të më ishte dukur fytyrë e parë.

- Bismil-llahi... ! – urova me zë të pakët, sapo hapa bllokun e shënimeve dhe nisa të shkruaj diçka për veprimtarinë që po zhvillohej.

- Ja panda mazi !...- tha burri përballë meje me zë më të fortë se timin. Foli që ta dëgjoja edhe unë. E bëri, ndoshta për rimë... Buzëqeshi çiltër dhe sytë i shkëlqyen nga kënaqësia që ndjeu ngase kishte krijuar huti tek unë me ato fjalë që kishte thënë. Mbeta pak çaste pa gojë. E kapa kuptimin e fjalëve të tij, "Përgjithmonë bashkë!", po nuk e kisha pritur që ai të ishte nga vendi fqinj, në gjuhën e të cilit foli.

Pas pak nisëm të bisedojmë në një gjuhë tjetër, të cilën e dinim më mirë të dy dhe ato që mësova prej rrëfimit të tij më hutuan edhe më.

- Unë kam lindur në Kairo, - nisi të më kallzonte bashkëbiseduesi.- Ndoshta u habite, po me këto tespie jam duke bërë Dhikr. Përmend Allahun... Arabishten e zotëroj mirë. Prindërit e mi i kam patur diplomatë, madje prej brezash diplomatë dhe i tillë më takon të jem edhe unë. Gruan dhe djalin i kam me shërbim në Londër. Nuk mund t'i sjell ata në këtë rajon të tillë ku jetojmë dhe ku unë jam me shërbim... Tradicionalisht i përkas një feje tjetër, por Islamin e njoh mirë; pesë shtyllat, shehadeti ... Kjo fe është burim mirësish. Kjo fe ka në thelb atë që unë shpreha në gjuhën e kombit tim: Përgjithmonë bashkë!... Dhe në qoftë se je besimtar i vërtetë, siç përpiqem të jem edhe unë, të lutem thellohu në këtë të vërtetë të madhe dhe së pram flasim...

I shënova fjalët e tij në bllok me shumë dëshirë e kënaqësi, me premtimin se do t'i plotësoja më vonë me të tjera përsjatje e mendime.

Mirësitë e të qënit bashkë janë të mëdha. Ka shumë rëndësi që njerëzit të jenë bashkë, përgjithmonë bashkë...

Së pari, duke qënë bashkë, të gjitha faljet, lutjet, adhurimet bashkohen dhe marrin më shumë fuqi, duke u nisur me përforcime drejt Dritës së të Madhit Zot; kjo dritë e shton ndriçimin, plot mëshirë e begati tek të gjithë, duke ndriçuar sipas meritës edhe zemrën e çdo njeriu. Mëshira e Zotit shumëfishohet kur jemi bashkë, duke nisur nga një njeri me besim, i plotësuar, pastaj bëhet një familje e bashkuar, me besimtarë (Ymet) të bashkuar, akoma më shumë njerëzim i bashkuar. Duke qënë bashkë dhe me besim, qënia njerëzore përforcohet; tek njerëzit besimtarë vijnë edhe engjëjt e bashkësia rritet në sasi e cilësi, të gjithë luten e falen për të lypur mëshirën, ndihmën dhe mirësitë e pafund të krijuesit...

Së dyti, duke qënë bashkë, kënaqësia e Zotit plotësohet më mirë. Kur krijuesi është i kënaqur me ne, njerëzit e bashkuar, atëhere mirësitë dhe begatitë eTij rrjedhin si lumë. Qëllimi i krijimit të njeriut dhe njerëzimit është adhurimi i krijuesit dhe plotësimi i kënaqësisë dhe porosive të Tij. Duke besuar dhe duke qënë bashkë si njerëz, plotësojmë njërën ndër porositë më të mëdha të Librit të Shenjtë, Kuranit, vepër e Krijuesit: "Mos u përçani!"

Së treti, duke besuar dhe duke qënë gjithmonë bashkë mëshira e Zotit, begatitë dhe ndihma prej Tij duket sikur vjen më lehtë dhe me vlerë të shtuar. Njerëzve u shtohen shpresat, u rritet besimi dhe optimizmi për të ardhmen. Adhurimi dhe shpërblimi shkojnë gjithmonë bashkë, po ashtu edhe besimi dhe veprat e mira shkojnë gjithmonë bashkë në veprimtarinë njerëzore.

Së katërti, duke qënë gjithmonë bashkë, në shoqëri të njëri-tjetrit njeriu detyrohet, e ka më për voli dhe ndihmohet të ndërtojë marrëdhënie vëllazërore me shoku-shokun, si për punët e botës, të kësaj bote, por edhe për punët e ahiretit ... Të qënurit bashkë e forcon njeriun në luftën e përditshme ndaj egoizmit të vet, ndaj veseve dhe gabimeve njerëzore dhe e orienton të bëhet më i mirë, më i virtytshëm, duke marrë shembull nga njerëzit më të devotshëm në shoqërinë e bashkuar. Vëllazëria e përgjithshme, përkrahja e përgjithshme e motivon individin dhe i jep krahë për të shtuar besimin dhe veprat e mira, për të kaluar një jetë për së mbari. Bashkimi me njerëz të mirë, qëndrimi me ta, nxit këshillimin për të gjitha problemet e kësaj jete dhe të tjetrës të panjohur, nxit dhe inkurajon me të madhe ndihmën ndaj njëri – tjetrit, ngritjen në një shkallë të lartë të solidaritetit ndërnjerëzor...

Këto ishin disa nga mendimet që më nxiti thënia e mençur e mikut tim nga vendi fqinj, i cili e kishte kuptuar fare mirë domethënien e të qënit besimtar i vërtetë në këtë botë, e cila po bëhet gjithnjë edhe më e vështirë, gjithnjë edhe më pak e kuptueshme për ata që nuk besojnë ...

Ai ishte në ato vite Konsull i Përgjithshëm i Greqisë në qytetin tim, pastaj u bë Sekretar i Përgjithshëm për Punët e Jashtme dhe tani vazhdon punën diplomatike bashkë me familjen, si besimtar i vërtetë dhe i mençur, sepse kishte mësuar që në fëmini gjuhën e bekuar të Kuranit Lavdiplotë, kishte marrë bazat e fesë së vërtetë dhe besonte tek mirësitë e kësaj bote dhe tek njerëzimi përgjithmonë i bashkuar...

Quhej Nikos Garilidhis, por mua më pëlqente ta thërisja Niko Gradhlidhësi, emër të cilin edhe ai e pëlqente shumë dhe qeshte me gjithë shpirt kur e dëgjonte prej meje, kur takoheshim dhe ndaheshim si besimtarë të vërtetë me fjalën e bekuar Selam Alejkum!...

| XHEMAL BALLA |

Feja në aspektin edukativ, në besimin te Zoti - II

1. **Marrëdhëniet e imamit me xhematin**

Problemi i marrëdhënieve të imamit me xhematin është problem kyç ku ndërthuren koncepte, parime dhe normat kryesore të edukatës fetare. Imami dhe xhemati janë dy bashkëpunëtorë të ngushtë në kryerjen e riteve të adhurimit. I pari si drejtues i tërë proceseve të faljeve dhe xhemati si ndjekës i tij, për të njohur e përvetësuar mësime teorike dhe praktike të ritualeve të faljeve siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të Islamit. Për të kryer ritualet e pesë kohëve të namazit, apo adhurimeve të tjera, që përcaktojnë kushtet e besimit të myslimanit, duhet të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë mes imamit dhe xhematit e të vendosen marrëdhënie të drejta midis tyre për të ndihmuar reciprokisht njëri tjetrin. Këto marrëdhënie duhen parë në dy aspekte kryesore: në procesin e kryerjes së ritualeve të faljes së namazit dhe jashtë tij, në vazhdimin e udhëzimeve e normave edukative të Islamit. Kjo e rrit akoma më shumë rolin e imamit si edukator, sepse ka të bëjë me mosha të ndryshme, brezi i ri, mosha e mesme dhe ajo e moshuar. Takti dhe mënyra e komunikimit me secilin prej tyre nuk duhet të jenë të njëjtë, por të diferencuar. Zoti në Kur'an thotë: "Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu u dërgoi profetët me lajme të mira dhe paralajmërime. Bashkë me ata, Ai zbriti edhe Librin me të vërtetën, për t'i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin. Mirëpo, njerëzit u grindën midis tyre, pasi u erdhën shenjat e qarta, nga zilia që kishin për njëri-tjetrin. Atëherë, me vullnetin e Vet, Allahu i udhëzoi besimtarët që ta kuptonin të vërtetën, lidhur me çështjet për të cilat të tjerët nuk pajtoheshin. Allahu shpie në udhë të drejtë kë të dojë."[1].

Imami historikisht ka qenë dhe mbetet figura e nderuar e fesë islame përpara komunitetit ku jeton e punon. Vetë ai është njeri si gjithë të tjerët, por natyra e punës së tij ka disa veçori specifike. Ai bëhet pjesë e gëzimeve dhe hidhërimeve që ndodhin në komunitetin e tij. Problemi i këtyre marrëdhënieve ka edhe bazën e tij fetare si përcjellës i mesazhit të ligjeve të fesë islame, për edukimin e njerëzve me besimin te Zoti dhe zbatimin e ligjeve të Tij. Sigurisht janë vetëdija dhe ndjenjat e njerëzve që e rrethojnë që përcaktojnë edhe motivet e veprimtarisë edukative të imamit. Prandaj këto marrëdhënie duhet të ndërtohen në mënyrë që të zgjerohet interesi i xhematit brenda xhamisë dhe atyre jashtë saj. Karakteri i vetëdijshëm i imamit dhe metoda që përdor për bindjen e njerëzve, shprehin orientimin e gjithë punës së tij për të përdorur fenë islame si element i fuqishëm edukativ, që duhet të zërë vend në edukimin e përgjithshëm qytetar. Për këtë arsye duhet një bashkëpunim i lirë dhe i ndërgjegjshëm për zbatimin e normave dhe parimeve të edukatës islame. Figura e imamit, personaliteti i tij i lartë, horizonti kulturor, vëmendja

1. "Kur'an", El-Bekare, 2:213.

dhe dashuria për njerëzit, do ta bëjnë atë të dashur e të respektuar në mesin e tyre. Kërkesa e tij ka karakter objektiv të drejtë, sepse ai shpreh detyrën që i është ngarkuar dhe dëshirën e tij për ta plotësuar sa më mirë. Këmbëngulja e tij në zbatimin e legjislacionit islam, që e mbron besimtarin nga çdo ves negativ, është kushti kryesor i pozitës së tij si imam.

Roli udhëheqës i ritualeve folëse, veçanërisht i predikimeve të ditëve të premte dhe festave fetare, i jep vlerën atij, sa ai është i përgatitur nga ana e kulturës fetare për t'i bërë ato elemente edukativë, parandalues në luftën ndaj dukurive negative sociale.

Në shpjegimin e hytbes është me shumë interes roli i imamit, përgatitja e tij, të folurit, mimika, gjallëria, saktësia në vërtetësinë e asaj që paraqet, etj. Një imam që nuk ka të folur elokuente, që përdor fraza të rëndomta, nuk e tërheq xhematin e tij nëpërmjet hytbes që paraqet. Nëse ai është indiferent ndaj dëgjuesve që ka përpara, nuk ka se si të krijojë interes dhe të tërheqë vëmendjen e tyre për ta dëgjuar. Me një të folur të përpunuar, me një zë normal, jo me thirrje, jo me zë të lartë e çirrje, etj., nuk do të bëhet i bezdisshëm për dëgjuesit e tij. Nuk mund të krijojë marrëdhënie të mira me xhematin një imam që predikon me nervozizëm, apo sillet sikur flet me vetveten, pa krijuar tek ata asnjë lloj emocioni. Çdo të premte imami duhet të sjellë para xhematit probleme të reja të kohës, të cilave vetëm Islami u jep zgjidhjen e duhur dhe të drejtë, duke parandaluar shfaqjet negative si dhuna në familje, keqtrajtimi i gruas, etj. Çiltërsia e imamit në predikim e komunikim me besimtarët, toni i ngrohtë, zgjedhja me kujdes e shprehjeve, kthjelltësia e mendimeve dhe konkretizimi i tyre me argumente nga Shpallja Hyjnore, Kur'ani Famëlartë, apo Hadithi i profetit Muhamed a.s., e rrisin shumë autoritetin e tij dhe bëhet më i dashur për ta, kështu edhe efekti edukativ është më i lartë. Kështu njeriu, si nga ana fizike, ashtu edhe nga ajo shpirtërore, duhet ushqyer me këto mësime dhe përmbajtja të bëhet me lutje, për të cilën Zoti i Lartësuar në Kur'an thotë: "O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta) pasi na ke udhëzuar në rrugë të drejtë dhe na jep mëshirë prej Teje. Vërtet Ti je Dhuruesi i Madh"[2].

2. Mësimet fetare mbi edukatën

Feja islame përmbledh një tërësi mësimesh, udhëzimesh dhe dispozitash ligjore të posaçme vetëm për njeriun në tërësinë e aktivitetit të tij jetësor si individ, në familje dhe në shoqëri. Një vend i veçantë me strategji të përcaktuara i kushtohet edukimit të njeriut, mënyrës së sjelljes dhe procesit të mësuarit të tij, që ndikojnë në pastrimin dhe fisnikërimin e forcave të brendshme shpirtërore, e bëjnë atë të ndjeshëm për të qenë i sinqertë në marrëdhëniet me të tjerët, në përputhje me normat e parimet e Islamit. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar edukimit të brezit të ri, duke filluar që nga mosha e fëmijërisë, marrëdhënieve të prindërve me fëmijët, të fëmijëve me prindërit dhe me njëri tjetrin, sjellja e fëmijëve në familje, jashtë saj dhe në shkollë me mësuesit dhe shokët e tyre. Si lëndë teorike duhet të merren e të trajtohen "Edukata fetare", "Morali" dhe "Akaidi (besimi)", nëpërmjet të cilave duhet të kultivojmë te fëmijët dhe gjithë brezi i ri humanizmin, etikën e sjelljes, të respektojmë dhe të afirmojmë të drejtat e tyre, të shmangen nga shfaqet negative devijuese si alkooli, droga, prostitucioni, dhuna, konflikti, etj.

Misionin parësor në edukim, në përgjithësi, duhet ta luajë kuadri fetar, imami, myftiu, etj. Personaliteti i tyre duhet të jetë i përsosur. Ai duhet të jetë personifikimi i njeriut të ndershëm, i ditur dhe me vizion. Autoriteti i tij varet nga sjellja e tij në përmbushjen e misionit fisnik në mjedisin e komunitetit ku jeton.

Mësimet e fesë kanë si objekt njeriun, për përparimin e personalitetit të tij. Mbi këtë bazë kuadri fetar studion edhe elementë të veçantë, rrethana e kushte konkrete, që deformojnë zhvillimin e tij si individ. Për këtë kategori

2. "Kur'an", Al 'Imran", 3:8.



individësh përdoren edhe nocione të veçanta nga Kur'ani Famëlartë, që kanë të bëjnë me edukimin, me parimet themelore të edukimit, të formimit dhe zhvillimit të njeriut.

Feja e trajton kuptimin dhe rolin e edukatës si një proces që realizohet gjatë gjithë jetës, por shkolla luan rolin e saj të rëndësishëm. Për këtë qëllim feja duhet të vendoset edhe në programin shkollor. Ajo i kushton vëmendje të veçantë edhe edukimit të njeriut për punën. Të kuptuarit e dobisë dhe nevojave të punës është objekt i njeriut, që ai të jetë i përgatitur për jetën. Për këtë arsye personalitetet e kulturës fetare nuk duhet ta lenë mënjanë këtë problem, veçanërisht me brezin e ri, të ndikojnë në formimin e tyre me dashuri për punën dhe aftësi për ta realizuar atë në tërë procesin jetësor.

Edukimi ka si synim, në radhë të parë, besimin dhe respektin pa kushte ndaj Krijuesit, Zotit të Lartësuar. Njeriu duhet edukuar në mënyrë të tillë që të plotësojë pa kushte urdhrat dhe ndalesat e shprehura nga legjislacioni islam. Por sot ka mjaft njerëz që qëndrojnë indiferentë ndaj mësimeve dhe edukatës fetare dhe arrijnë deri atje sa i konsiderojnë ato si të vjetruara dhe anakronike. Këta njerëz janë të prirur t'i shkelin ato ligje në emër të civilizimit të shoqërisë. Asgjë nuk e dëmton Zotin dhe nuk i shtohet, ose pakësohet ndonjë favor si nga lavdërimi ashtu edhe nga mohimi. Përkundrazi, këta njerëz dëmtojnë veten e tyre. Në një Hadith të profetit a.s. thuhet: "Allahu xh.sh. nuk do që njerëzit të dëmtojnë veten, duke u rebeluar, prandaj edhe i ka krijuar me karakterin, prirjen që ta njohin ekzistencën dhe Njëshmërinë e Tij, si dhe ta respektojnë Atë"[3].

Zoti i lartësuar e ka lënë të lirë njeriun për të zgjedhur besimin e tij dhe respektin ndaj Zotit dhe ligjeve të tij. Zoti në Kur'an thotë: "Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit! Nëse ju i ktheni shpinën të Dërguarit tonë, dijeni se ai ka për detyrë vetëm që t'ju shpjegojë qartë"[4]. Do të thotë se predikuesit e lëndëve fetare, duhet të bëjnë detyrën dhe të përcjellin me saktësi mësimet e fesë, ndërsa zbatimi mbetet në dëshirën e njerëzve për të zbatuar vullnetin e lirë. Mirëpo, njeriu në vend që të zbatojë ligjet e Allahut, bëhet servil dhe zbaton urdhrat e porositë e atyre që e konsiderojnë fenë si të vjetruar. Këtyre personave, Zoti në Kur'an u përgjigjet e thotë: "O i Dërguar! Ki frikë Allahun dhe mos i dëgjo jo besimtarët dhe hipokritët! Me të vërtetë Allahu është i Urtë e i Gjithëdijshëm"[5]. Në Kur'an dhe në hadithe të profetit a.s. edhe në libra të tjera fetare që e kanë burimin në këto materiale, është argumentuar mirë çështja e besimit. Por njeriu është lënë i lirë të zgjedhë, sepse duke bazuar në këtë zgjedhje ai do të përgjigjet nesër në jetën e pasosur përpara Krijuesit, Zotit të Lartësuar. Ky bën edhe diferencimin mes sistemeve njerëzore dhe Ligjeve Hyjnore. Mësimet Hyjnore nuk janë të bazuara në teori pa baza, por janë mësime që kanë ardhur nëpërmjet të Dërguarve të Zotit. Pikërisht për këtë, Kur'ani Famëlartë, si Libër Hyjnor, ka urdhëruar besimtarët që ta respektojnë profetin Muhamed a.s. Në Kur'an thuhet: "Thuaju (o Muhamed): 'Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë'."[6] Prandaj edhe Muhamedi a.s. thotë: "Largohuni nga gjërat që u kam ndaluar dhe bëni aq sa të keni mundësi nga ato që ju kam urdhëruar"[7].

Respekti për të Dërguarin e Allahut dhe ecja në rrugën e tij është tregues i dashurisë për Allahun dhe parakushti për t'u dashur dhe falur nga ana e Tij. Këtë formim duhet të marrin nxënësit në shkollë dhe masa e gjerë e besimtarëve nëpërmjet predikuesve të mësimeve fetare.

3. Buhari, Xhenaiz, 79.
4. "Kur'an", Et-Tegabun, 64:12.
5. "Kur'an", El-Ahzab, 33:1.
6. "Kur'an", Al 'Imran", 3:31.
7. Buhari, I'tisam, 2.

Rruga që ndiqet, mënyra se si merret për bazë dhe se si shprehet mendimi, ndjenja, dija, përcaktimi dhe përvoja, quhet artikulimi i të folurit (Uslup). Çdokush ka artikulimin e tij të veçantë në të folur. Mënyra e artikulimit shfaq nivelin e dijes, moralin, karakterin, filozofinë e jetës dhe botëkuptimin e personit. Artikulimi është po aq i rëndësishëm sa vetë mesazhi i dhënë në shkrim apo fjalim. Madje në shumicën e rasteve është aq ndikues tek lexuesi apo dëgjuesi sa që e lë pas edhe mesazhin që përcjell. Për këtë arsye duhet

NDJESHMËRIA E SAHABEVE NË TË SHPREHUR

treguar kujdes në të shkruar dhe në të folur dhe i duhet dhënë rëndësia e duhur mënyrës së artikulimit. Gjithmonë duhet patur parasysh koha, vendi dhe kushtet, duhet kujdes në mimikë dhe gjeste dhe njëkohësisht duhet t'i tregohet rëndësi e veçantë tonit të zërit dhe fjalëve të përzgjedhura.

Sahabet e nderuar të cilët ishin edukuar nga Rasulallahu (a.s.) me edukatën hyjnore, ishin shumë të kujdesshëm në çdo aspekt. Mundoheshin që çdo punë ta kryenin brënda kornizës në lidhjen e tyre me Allahun, me bindjen ndaj të dërguarit të Tij dhe marrdhënieve më të tjerët. Kjo ndikonte në gjëndjen e tyre, përpjekjen dhe mundin që tregonin, ndikonte në ndjenjat dhe mendimet e tyre por njekohësisht ndikonte edhe në mënyrën e artikulimit të fjalës së thënë. Situatat me të cilat përballeshin, ua shpjegonin njerëzve që kishin rreth vetes në mënyrë që të përfitonin sa më shumë nga eksperiencat e tyre. Këtë e bënin duke treguar një kujdes të veçantë dhe kjo ndikonte edhe ne artikulimin e tyre. Nëse ngjarja me të cilën përballeshin ishte negative, atëherë, pa përmendur emra të veçantë, jepnin mesazhin e duhur. Në këtë mënyrë, shpëtonin vetet nga përgojimi, nuk turpëronin përsonin i cili kishte rënë në gabim, nuk ofendonin miqtë dhe të afërmit e tij dhe parandalonin mendimet negative që mund t'u vinin në lidhje me atë person.

Pa dyshim se kjo ndjeshmëri, tregon një shembull morali të marrë nga Kurani dhe i dërguari i Zotit. Kurani dhe Rrasulullahu (a.s.), kur na njoftojnë mbi ndodhitë e popujve nuk qëndrojnë mbi emra konkretë por mbi gabimet e tyre. Kur i dërguari i Allahut (a.s.) donte të zgjidhte një problem apo të rregullonte një gabim, mundohej të mos përmendte askënd por thoshte se "ç'po ndodh me ju që ju shikoj duke vepruar kështu?" [1] dhe e zgjidhte problemin pa ofenduar asnjërin prej atyre që e kishin atë gabim.

"Muhaxhiri i Ummu Kajsit"

Në periudhën e Hixhretit, një Mekkas emigroi në Medine për tu martuar me një grua e cila quhej Ummu Kajs. Kur është pyetur i dërguari i Allahut (a.s.) nëse do të ketë sevapet e hixhretit ky njeri apo jo, Ai (a.s.) tha :

- "Punët (veprat) janë sipas qëllimit (nijetit). Çdokush do të përfitojë atë që ka patur për qëllim. Kush emigron për të fituar kënaqësine e Allahut dhe të dërguarit të Tij, emigrimi tij është për Ata. Kush emigron për të përfituar diçka të kësaj bote ose për tu martuar me dikë, emigrimi tij është për atë çka synon."[2]

Shpjegimi i Rrasulullahut (a.s.) tregonte se kishte nje problem tek nijeti dhe se duhej ndryshuar. Sahabët e nderuar të cilët nuk donin të ofendohej ai person, madje edhe pse e dinin emrin e tij, nuk e kanë përmendur, por kanë përdorur termin "muhaxhiri i Ummu Kajsit."

"Një grua"

Një ditë Rrasulullahu (a.s.) kishte shkuar për vizitë në varreza, ndoshta për të vizituar miqtë e tij. Ndërkohë që në atë moment pa nje grua që qante me të madhe mbi varrin e të birit dhe përdorte fjalë të papërshtatshme me besimin. Ishte mërzitur për gjendjen e gruas. U afrua afër saj dhe dëshi ta këshillonte. Por gruaja nuk e kishte njohur se kush ishtë ai dhe "hiqmu qafe, ti nuk e di (kupton) se çfarë më ka ndodhur mua!" i tha. Pas kësaj, Pejgamberi i mëshirës u largua pa i thënë gjë tjetër.

Më vonë të pranishmit e njoftuan gruan se ai që dëshiroi të të këshillonte ishte i dërguari i Allahut (a.s.). Gruaja ishte prekur shumë nga kjo. Sepse kishte mërzitur Rrasulullahun (a.s.) edhe pse pa vetëdije. Duhej që ta rikuperonte gabimin duke i kërkuar falje të sinqertë. Menjëherë sapo mori veten shkoi tek shtëpia e tij. I kërkoi falje e turpëruar. Rrasulullahu (a.s.) e fali atë dhe në këtë kontekst tha: "Durimi është ai që tregohet në momentin e goditjes."

Sahabët të cilët transmetojnë hadithin me në krye Enes ibni Malik (r.a) nuk e përmendin emrin e kësaj gruaje të shokuar nga ngjarja e rëndë por përdorin termin "nje grua" në mënyrë që të mos paragjykohet ose ofendohet nga gabimi.[3]

"Një djalosh"

Një ditë kur Rasulullahu (a.s.) po bisedonte me shokët në xhami hyri dikush dhe i afrohet atij. Më pas me një zë të lartë, saqë e dëgjonin dhe të tjerët që ndodheshin të pranishëm, thotë: "O i dërguari i Allahut! Më jep leje të bëj zina (imoralitet)." Kjo kërkesë e papritur ndikon keq tek ata që ndodheshin prezent dhe filluan ti bërtisnin dhe ta ofendonin. Ndërkohë që Rrasulullahu (a.s.) e ruan qetësinë, i ndalon të flasin të tjerët dhe i kërkon djaloshit të ulet përballë tij.

Dhe e pyet: "A dëshiron ti që të bëhët zina me nënën, vajzën, motrën, hallën dhe tezen tënde?"

Ai i thotë: "Ç'është ajo fjalë o i dërguari Allahut, sigurisht që nuk dëshiroj!"

Rrasulullahu (a.s.) i thotë: "Edhe njerëzit e tjerë nuk dëshirojnë të bëhet zina (imoralitet) me nënat, vajzat, motrat, hallat dhe tezet e tyre."

Më pas Rrasulullahu (a.s.) vendos dorën në gjoksin e tij dhe i lutet Allahut për të: "O Zoti im ! Falja gabimin, pastroja zemrën dhe ruaja nderin."[4] Djaloshi pasi bindet dhe qetësohet nga fjalët e të dërguarit të Allahut (a.s.), largohet.

Ebu Umame (r.a.) i cili transmeton këtë hadith, edhe pse e dinte emrin e tij, përdor termin "një djalosh". Në këtë mënyrë nuk ofendohet as ai dhe as pasardhësit e tij kur e dëgjojnë historinë e këtij djaloshi të ndershëm, të martuar nga vetë Rrasulullahu (a.s.) dhe për të cilin kur ka rënë dëshmor i dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë që "është humbja ime." Dhe në këtë mënyrë mjaftohet për ta përmendur si ndodhi për të nxjerrë mësim.

Rezultati

I derguari i Allahu, Muhammedi (a.s.) me mënyrën e të folurit, të komunikuarit dhe me sjelljen e tij ka ndikuar shumë në mënyrën e jetesës së shokëve te tij. Duke marrë shembull atë, sahabet janë treguar shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e fjalëve që transmetonin. Në këtë mënyrë, nuk është lënë mundësia të ofendohet askush dhe asnjëri nuk është detyruar të mbajë mbi supe gabimet e të parëve të tyre që kishin bërë në shoqëri. Po ashtu, as transmetuesit dhe lexuesit e ngjarjeve nuk bëheshin pjesë e përgojimeve.

Duhet të jetë një kriter i fortë për çdonjërin prej nesh mënyra e të folurit, të shkruarit dhe sjelljes së këtyre njerëzve të dashur të Allahut, të cilët janë një busull orientuese për të gjithë myslimanët.

1. Ebu Davud, Edeb 5.
2. Buhari, Bedu'l-Vahy 1; Muslim, İmare 155; Ebu Davud, Talak 11
3. Buhari, Cenaiz 32, 43, Ahkam 11; Müslim, Cenaiz 14, 15
4. Ahmed İbn-i Hanbel, Musned 36/545 (22211)



Devocioni dhe dinjiteti, *ky është sekreti ! ...*

(Devocioni i besimtarit, si miniera e arit ...)

Virtyti kryesor, karakteristika themelore, cilësia më e vyer, më e çmuar, më e vlerësuar dhe më e shpërblyer në personalitetin e besimtarit të vërtetë është Devocioni, Devotshmëria. Devotshmëria është adhurim, përmbledhëse e të gjitha të mirave njerëzore dhe ruajtëse e begative të krijuesit; është besim, bamirësi, dobishmëri, falje, mëshirë, thjeshtësi, pendim. Devotshmëria ndaj krijuesit është burim i të gjitha të mirave në jetën e njeriut; është besnikëri, siguri, shpresë. Devocioni e bën njeriun vital, jetësor, gjallnik; e bën atë të përtërirë, sikur të lindë çdo ditë me dashurinë e madhe në zemër për krijuesin, me adhurimin pa kufi për mëshirën e pafundme. Besimi i sinqertë dhe bindja ndaj Zotit, si dhe besimi në cilësitë pozitive të vetë njeriut dinjitoz, sjellin devotshmërinë e vërtetë; besimi është shpëtim, devocioni është lartësim i njeriut, minierë e pashtershme mirësish në jetën e njeriut...

Devocioni nuk është një gjë abstrakte, as edhe një gjë materiale, lëndore, por materializohet në idetë, idealet që e ushqejnë vazhdimisht njeriun gjatë jetës së vet si dhe në veprimtarinë jetësore konkrete të përditshme. Devotshmëria ecen gjithmonë sipas porosisë kuranore: Beso dhe bëj vepra të mira!...

Farën, bërthamën e devotshmërisë e ka çdo njeri, i cili vjen në këtë botë, si dhuratë nga krijuesi i gjithësisë, ndërkohë që besimi i drejtë, i vërtetë, i sinqertë, edukata, kultura dhe dituritë e pashtershme janë rrënjë që dalin prej saj dhe e ushqejnë atë pa rreshtur, përditë. Bashkë me burime të tjera begatie e mirësie...

Kuptimi dhe thelbi i devocionit.

Devocioni, në kuptimin e përgjithshëm të kësaj fjale, është një ndjenjë e lartë, e pastër dhe e zjarrtë respekti, çmuarjeje dhe nderimi ndaj dikujt a diçkaje me meritë; gatishmëria për të bërë gjithçka për të. Ligjshëm lind pyetje : kush është ai "dikush", apo "diçka " që e meriton me të drejtë Devocionin, devotshmërinë e njeriut ?! Është ndonjë njeri tjetër, a ndonjë grup njerëzish (parti-pjesë), ndonjë kafshë tejet e fuqishme, ndonjë planet, yll, hënë, apo diell; ndonjë udhëheqës, sundimtar, faraon e firaun, apo kush tjetër?! Vetëm Allahu, Zoti Suprem, fajfalës e mëshirëmadh e meriton me të drejtë ta fitojë devocionin, devotshmërinë e njeriut, krijesës së Tij më të dashur ! Vetëm Zotin adhurojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, vetëm ndaj Tij jemi dhe duhet të jemi përjetë krejtësisht të devotshëm, të dorëzuar, shpresëplotë; Zotit të gjithësisë i përket devocioni dhe përkushtimi ynë maksimal.

Njeriu besimtar ka nderim dhe dashuri të thellë për krijuesin; ai është thellësisht besnik deri në fund ndaj Tij, vepron e punon me devocion, bën veprime që shprehin devotshmëri në brendësi, në thelb të vet dhe që në disa aspekte e shfaq hapur atë. Besimtari i devotshëm shpreh gradën më të lartë të besimtarit. Besimtari i devotshëm ka edhe një zemër të devotshme, fjala e tij priret të shprehë devotshmëri të brendshme e të jashtme të qartë. Devotshmëria e besimtarit bën mrekulli në jetën e njeriut, si shpërblim i merituar. Të devotshmit i frikësohen krijuesit në çdo çast, por në të njëjtën kohë shpresojnë mirësi e dashuri si shpërblim në mënyrë të natyrshme në jetë. Devocioni është bekim...

Devotshmëria shkëlqen me tërë fuqinë e dritës së vet në muajin

e Madhnueshëm të Ramazanit, shpërblesat e të cilit për të devitshmit janë të pakufishme dhe të pamatshme, gëzim e shpresë për agjërimtarët dhe njerëzit e tjerë shokë të tyre.

Devotshmëria tek njeriu besimtar i vërtetë ruhet e zhvillohet në të gjitha fazat e jetës së tij, kur ai është mirë dhe i shkojnë punët në rregull, por edhe kur është në vështirësi e punët nuk i ecin mbarë, për shkaqe dhe arsye të ndryshme, kryesisht njerëzore, vetjake e sociale. Madje në periudhat më të vështira të jetës, devotshmëria e besimtarit del në dritë dhe shkelqen me të gjithë bukurinë e vet mahnitëse dhe shpëtimtare, duke e kthyer, me këtë dritë jetëdhënëse, gjithçka për mbarë dhe mirë. Devotshmëria e fisnikëron njeriun, frenon epshet natyrore të tij, i kthen ato nga të dëmshme e shkatërrimtare, në të dobishme dhe në burim kanaqësie trupore e sidomos shpirtërore...

Mund të jesh i devotshëm edhe kundrejt ndonjë njeriu të dashur, të çmuar e të shtrenjtë të jetës tënde, por ky devocion është i përkohshëm, jo i plotë e jo plotësisht i merituar, sepse këtë devotshmëri njeriu tjetër nuk ta njeh mirë, nuk ta kupton, s'ta çmon, e nuk ta vlerëson siç duhet, nuk ta shpërblen me të njëjtën masë dhe formë, gjë që të çon shpesh në zhgënjim, shkurajim, mosbesim, zemërim, pendim... Megjithatë edhe ndaj njerëzve të tjerë, të dashur, të shtrenjtë e të çmuar, duke e nisur nga prindërit tanë, bashkëshortët, fëmijët, mësuesit, etj., ne duhet të jemi të devotshëm, natyrisht brenda kufijve të lejueshëm, brenda masës, pa prekur dinjitetin tonë njerëzor... Të jesh i devotshëm edhe ndaj njerëzve nuk don të thotë domosdoshmërisht të presësh ndonjë mirënjohje ose shpërblim prej tyre, as të përulësh veten, personalitetin dhe dinjitetin tënd; devocioni ndaj tyre bëhet për hir të Zotit dhe gjithçka që vjen më pas ndodh për hir dhe mëshirë të Tij...

Devotshmëria të çel sytë e zemrës, të dëlir**!...**

Devotshmëria e plotë, deri në sakrifikim është një gjë Ideale, një diçka e përkryer, të cilën synojnë ta arrijnë të gjithë besimtarët e vërtetë. Prej saj besimtari ndjen, kupton, me zemër e mendjen, thirrjen: Duaj!, Shërbe!...

Duaje Zotin dhe Njeriun!... Shërbeji Zotit dhe Njerëzve të Tjerë!... – me devotshmëri!

Njeriu nga vetë natyra e tij është gabimtar; ai gabon, me dashjen, apo pa dashjen e vet. Mirëpo, duke qënë i devotshëm, njeriu besimtar i mban gjithmonë çelur, hapur sytë e zemrës së vet, gjë që e ndihmën njeriun të dëliret vazhdimisht, të pastrohet nëpërmjet pendimit pa ndërprerje.

Dëlirësia është pastrim, kthjellim, çiltërsi, ndershmëri. Ne shpesh themi : Dëlirësi fëminore; sy plot dëlirësi; dashuri e dëlirë; zemër, ndërgjegje e dëlirë; farë e dëlirë; dal i dëlirë prej betimit; dëlirem, lahem, pastrohem çdo ditë; dëlirem, lahem nga një detyrim ose nga një faj, apo gabim,etj. Dëlirësimi i përditshëm është dëshmi e pendimit të sinqertë, kërkim i faljes, lutje për mëshirë e shpëtim.

Dëlirësimi i besimtarit të devotshëm e ka një kulm të vetin, një shkëlqim të vërtetë. Ky lartësim arrihet lumnueshëm në mujain e Shenjtë dhe të Begatë të Ramazanit, ku njeriu pastrohet krejtësisht, dëliret dhe vetëkthjellohet trupërisht dhe shpirtërisht, duke arritur lartësi të papara në jetën e kësaj bote.

Njeriu besimtar mëson të bëhet i devotshëm duke zbatuar porositë e Zotit shprehur në mënyrë të përqëndruar, të koncentruar në Librin e Shenjtë (Kurani Kerim), po ashtu mësime të mëdha devotshmërie njeriu merr nga jeta, vepra dhe fjala e Profetit Muhammed (a.s) dhe profetëve të tjerë, të cilët duke qënë të devotshëm ishin të dhemshur, të dashur, të përulur, të matur, të përkushtuar, të afrueshëm, të mëshirshëm, shërbyes ... Profeti i fundit është shembull i shkëlqyer devotshmërie e dëlirësie, modeli ideal për të gjitha kohrat dhe për të gjithë njerëzimin. Ja, si shprehet Mahatma K. Gandi, lideri i madh dhe i urtë politik dhe shpirtëror i lëvizjes indiane për pavarësi e përparim: " *Jo forca dhe shpatat, por ishin thjeshtësia e palëkundur, qëndrueshmëria absolute e Pejgamberit, përpjekja për të përmbushur zotimet e tij, përkushtimi intensiv për miqtë dhe pasuesit, guximi, trimëria, besimi absolut në Zotin dhe në misionin e tij, që duruan gjithçka dhe që kapëprcyen çdo pengesë.* "

Profetët nuk i don, nuk i nderon dhe nuk i duron dot njeriu që e ka zemrën e ligë, që është jashtë devotshmërisë. Hazreti Isa (a.s) e dënoi hipokrizinë e njerëzve, të cilët donin të nxirnin në pah Devocionin, që pretendonin se e kishin, duke këshilluar përgjithësisht njerëzit: "Kur bën një dhuratë, mos i bjer burisë para teje, ashtu siç bëjnë hipokritët! "

Devotshmëria dhe Dinjiteti- ky është sekreti ! ...

Në jetën e përditshme është e vështirë të krijosh dhe të ruash një raport ideal, të drejtë midis devotshmërisë dhe dinjitetit njerëzor. Pasi shpjegova më sipër kuptimin dhe thelbin e devocionit, devotshmërisë, tani më lejoni të shpjegoj me pak fjalë kuptimin dhe thelbin e fjalës Dinjitet.

Dinjiteti është tërësia e vlerave morale të njeriut ose të një grupi njerëzish; dinjiteti është vetëdija e vetë njeriut për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri si dhe nderimi e respekt për vetveten. Respekti,çmuarja, vlerësimi, nderimi për vetveten, por pa e tepruar, janë pjesë thelbësore të dinjitetit njerëzor. Ne themi : Dinjitet fetar; dinjitet kombëtar; dinjitet besimtari; njeri me dinjitet...

Dinjitet gjithashtu quhet cilësia e mirë apo vlera e lartë e diçkaje që e bën atë të çmohet, të vlerësohet bindshëm. Ne themi : Vepër plot dinjitet artistik e shkencor; tregim dinjitoz; ndërtim me dinjitet kombëtar; Islami është feja dinjitoze, ndaj së cilës njeriu duhet të tregohet i devotshëm!...

Raporti midis Devocionit dhe Dinjitetit është një proces i thellë ekuilibri, baraspeshimi, i fshehtë, i mrekullueshëm, që duhet ushtruar dhe kalitur përditë nga çdo njeri. Ne duhet të jemi po aq të devotshëm, sa edhe dinjitozë; po aq dinjitozë, sa edhe të devotshëm. Ne jemi krenarë, se jemi të devotshëm dhe dinjitozë për fenë tonë të lartë dhe kombin tonë të dashur. Këto janë dy veti thelbësore të njeriut, që nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, përkundrazi. Devotshmëria dhe Dinjiteti dalin nga e njëjta minierë ari...

Vlerësoje veten tënde! Kurrë mos e lërë veten pas dore ! Mos harro kurrë se je krijesa më e dashur e të madhit Zot dhe të jesh krenar, i gëzuar dhe mirënjohës për këtë fat të madh; përdore jetën tënde duke qënë dinjitoz, i devotshëm dhe plotësisht i përkushtuar për të realizuar me sukses qëllimin për të cilin je krijuar! ... Njeri, beso se fitorja të përket pikërisht ty! Ti je fitimtar se beson tek I Gjithfuqishmi!

Dëgjoji dhe shijoji tingujt e ëmbël të jetës; shikoji dhe kënaqu me të gjitha ngjyrat e ylberta të natyrës, sepse kënaqësinë e mirënjohësit, të drejtit, të ndershmit, të devotshmit dhe vepërmirit Zoti e shpërblen duke e qitur në jetë gjithmonë Faqebardhë dhe Fitimtar!...

Zoti na bëftë prej të tillëve!



Emri i Zotit "Allah "

Për rëndësinë e kësaj teme është me vlerë të themi se njohja e Allahut na udhëzon kah dashuria ndaj Tij, frika, shpresa ndaj Tij, na mëson në Mbikëqyrjen e Tij dhe të vepruarit me sinqeritet çdo vepër për Të, e s'ka dyshim se kjo është lumturia e njeriut, dhe nuk ka mundësi e formë tjetër në njohjen e Allahut vetëm se me njohjen e Emrave të Tij të bukur dhe studimi i domethënieve të tyre. Nëse njeriu do ti njohë dhe praktikojë kuptimet që shkëputen nga emrat dhe cilësitë e Allahut, atëhere do jetë më korrekt me veten dhe të tjerët.

Shënon Imam Buhariu, Muslimi nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) që thotë: i **Dërguari i Allahut (Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: Allahu i ka nëntëdhjetë e nëntë emra, kush i mëson, do të hyjë në xhenet, Ai** është Një (tek) dhe e do tekun" .

Shumë njerëz sot në vendet tona porsa dëgjojnë emrin e Allahut "Allah " në ezanin që thirret apo në përshëndetjet që thuhen midis besimtarëve, fillojnë e polemizojnë se përse duhet që të shprehen në arabisht ndërsa ne kemi gjuhën tonë. Dhe ndoshta disa të tjerë ndiejnë paragjykime porsa e dëgjojnë këtë emër e ndoshta disa të tjerë urrejtje pa ja njohur kuptimin. Thotë Allahu: **"Ata polemizojnë rreth Allahut..."**, (**Kuran, 13:13**).

Thotë Allahu: **"Allahu ka emrat më të mirë, andaj thirreni me ata." (Kuran, 7:180).** Dhe disa njerëz të tjerë ndërtojnë fe të posaçme për ndonjë nga emrat e Zotit, ndërsa Ai thotë në Kuran **"Thuaj: "Thërrisni: All-llah ose thërrisni Er Rrahman, me cilindo që ta thërrisni (me këta dy emra), emrat e Tij janë më të bukurit". (Kuran, 17:110).**

Emri ***"All-llah"*** është emër njëjës, jo i prejardhur nga ndonjë emër dhe askush prej "zotrave" apo njerëzve të mëparshëm nuk është emërtuar me këtë emër, porse ai është emër i posaçëm dhe i veçantë vetëm për Zotin e gjithësisë, të vetmin Krijues. Allahu xh.sh. thotë : "**A di ti për Të (Allahun) emërtues tjetër" ?! Kuran, 19:65).**

Të gjithë robërit e thërrasin dhe i luten Atij me fjalët: O Allah! Origjina e këtij emri në gjuhën arabe është "ilah" الٰه, *që do të thotë "i adhuruar", rrënja e fjalës* إله *"ilah" është "* ألوهة و إلهة يألُه ألٰه *elihe, je'lehu, ilaheten dhe uluheten" që do të thotë; "adhuroi, adhuron, adhurim" kështu që emri Allah* الله *është i përbërë nga pjesëza "*ال*" "eli" dhe fjala "*إله*" "ilah" (i adhuruar) si rrjedhojë kuptimi i emrit "Allahu" është: "i Adhuruari."*

Thotë H.Ibrahim Dalliu në librin e tij "Ajka e kuptimeve të Kurani kerimit" **, "** fjala e madhërueshme Allah ,është njëri nga emrat e bukur të Zotit. Me këtë emër, thirret vetëm i Adhuruari me të drejtë, që është Zoti. Allah nuk quhet tjetërkush përveç Zotit. Kur themi Allah na vjen ndërmend veta e Zotit e pajisur me të gjitha vetitë e plota që janë të merituesheme për madhërinë e Tij dhe pa asnjë të metë." Emri me më së shumti përdorim në Kuran, është emri 'Allah ', është përdorur plot 2699 herë.

Prej veçorive të tij është se ai është baza/origjina e të gjithë emrave të bukur të Allahut. Të gjithë emrat tjerë i atribuohen atij, dhe ai cilësohet përmes tyre. Allahu i Lartësuar thotë: **"Allahu, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij. Ai ka Emrat më të Bukur" (Kuran 20:8).** Prandaj, thuhet Err-Rrahman (i Gjithëmëshirshmi), Err-Rrahim (Mëshirëploti), El-Halik (Krijuesi), Err-Rrezzak (Furnizuesi), El-Aziz (i Plotfuqishmi), El-Hakim (i Urti), janë prej emrave të Allahut, dhe nuk thuhet All-llah është prej emrave të Err-Rrahmanit dhe Err-Rrahimit, apo prej emrave të El-Azizit, dhe kështu me radhë. Pra gjithë emrat e tjerë të Allahut burojnë nga ky emër.

Duhet ditur se vetëm me emrin **Allah** plotësohet dëshmia islame e cila është ***"La ilahe il-la Allah, Muhammedun resulullah".'' Ska të Adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij".***

Çdo gjë të cilën besimtari e vepron duhet ta fillojë me Bismilah pra me emrin e Allahut. Dhe kur ha, pi dhe lutet dhe me këtë emër hapen të gjitha kaptinat e Kur'anit. Thotë Profeti alejhi selam "**Çdo gjë me rëndësi që nuk ka filluar me bismilah është e privuar nga e mira**." Me këtë ti mëson se nuk ka zot tjetër veç Allahut, mëson se Ai është i vetmi Zot, mëson se Atij i drejtohet gjithkush për ndihmë, nga kjo mëson se vetëm Atij i duhet drejtuar për ndihmë, vetëm prej Atij duhet pasur frikë, Ai është Furnizuesi, Kontrolluesi.

Emri i madh i Allahut është pa dyshim vetë emri"Allah". Transmetojnë Ibn Xheriri dhe Hakemi nga Seid bin Ebi Vekasi e ky nga Pejgamberi alejhi selam të ketë thënë: "A t'ju tregoj për emrin e madh të Allahut? Ai emër është në "duanë e Junusit" që e bëri në bark të peshkut: **"nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje unë isha prej të padrejtëve"** Disa e pyetën: A mos ka qenë kjo dua e veçantë vetëm për Junusin a.s.? ai u përgjigj: **"A nuk e shihni se ç'thotë Allahu xh.sh. -"Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuam nga tmerri. Kështu i shpëtojmë Ne besimtarët"** (Kuran, 21:88).

Nëse njeriu kur përmend emrin e ndonjë të dashuri gëzohet dhe përmallohet, atëhere si është çështja me Zotin e njerëzve, të adhuruarin e njerëzve, me përmëndjen e të Cilit gjen rehati dhe përgjigje ai që e beson dhe ai që nuk e beson atë.

Thotë Allahu: **"...dhe me të përmendur All-llahun zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen."** (Kuran, 13:28).

Me këtë emër Allahu i është prezantuar gjithë Pejgamberëve**, " O Musa Unë jam Allahu, Zoti i botrave.."**(Kuran, 28:30).

Përfundimi i njeriut që e shqipton dhe e beson këtë emër padyshim është kënaqësia e Allahut dhe xheneti i Ti. Thotë Profeti alejhi selam:"**Kush dëshmon se askush dhe asgjë përveç Allahut nuk meriton të adhurohet, i Cili është i Vetëm, pa rival dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij me sinqeritet nga zemra e tij do të hyjë në xhenet. "** (Buhari).

الله

JOINT RELIEF
COMMITE
ABRET ROOM

IRTI

BOTA JONË

| HAKI SAHITAJ |

Imam Gazaliu për debatin

"Nuk është kusht të pajtoheni me mua në mendim, është e mjaftueshme të kuptoni se çfarë dua të them ..." Ali Sheriati

Në Islam, koncepti rreth të cilit është ndërtuar kultura Islame është *ilm*-i apo dituria. Sigurisht, është një koncept që jo thjeshtë mund të përkthehet rëndom si dituri, por edhe si njohje, kërkim, përhapje; është fakt, e dhënë, dituri e urtësi.[1] Brenda kësaj pasurie kuptimesh qëndron dhe ideja e komunikimit. Të komunikosh, në këtë rast, do të thotë si është kuptuar Islami dhe si është aktualizuar në shoqëri.[2] Andaj komunikimin në historinë Islame e gjejmë në forma të ndryshme, nga traditat gojoret të përcjelljes së diturisë, deri tek format e ndryshme të shkrimit dhe shtypit, tek artet e bukura, arkitektura, shkenca etj. Brenda këtij procesi komunikimi, vend ka zënë edhe debati si rrugë për të përcjell tek te tjerët diturinë dhe njohur të vërtetën. Të gjitha këto aspekte integrohen përmes perspektivës etike të Islamit.

Në traditën Islame debati është një rrugë e stimuluar nga vetë burimet fetare[3], që të gjendet e vërteta dhe për të parë ku gjenden problemet. Ne jetojmë në një botë ku fati i njerëzve është i lidhur nga mendimet dhe veprimet e shumë më shumë njerëzve, andaj dhe të debatosh është një rrugë e duhur për t'u njohur me mendimet dhe veprimet e të tjerëve.

Sot kur bota në terësi, por dhe ajo muslimane në veçanti, po kalon në kohë të vështira, e për të kuptuar se sa vështirë është mjafton të nisemi nga debatet tona. Jo çdo thirrje apo nxitje për debat duhet marrë si provokim apo humbje kohe. Por, përtej qëllimit, që ne si qenie njerëzore nuk ia vëmë askujt në dyshim, qëndrojnë kritere se si mund të arrijmë një debat konstruktiv dhe për ta dëshmuar në veprim qëllimin të cilin kemi.

Debati ka qenë një rrugë apo traditë që nga gjeneratat e para, ku ne gjejmë tablo të shumta se si ata kanë debatuar për shumë çështje, madje dhe ka pasur shumë momente mospajtimesh.[4] Por si ka vazhduar të ruhet fryma e përbashkët e përkushtimit, vëllazërisë, aksionit e bashkëpunimit të ndërsjellë? Në përshtypjet e para duket se debati më shumë është nxitur për të shprehur superioritet, lëvdata, përfitime të ndryshme etj., se sa të zbulohet e vërteta. Për këtë problematikë kanë shkruar shumë dijetarë, e njëri nga ta është dhe Imam Gazaliu. Kush duhet të debatojë? Kur? Si dhe çfarë duhet të debatojmë, janë pyetje që Imam Gazaliu dhe të tjerë janë munduar t'u japin zgjidhje.

Siç e dimë Imam Gazaliu jetoi në një kohë kur bota muslimane po përballej vërtetë me trazira tepër serioze[5], nga ato te mospajtimeve teologjike, filozofike, juridike e deri tek konfliktet politike[6], aq sa e çuan botën muslimane në një dobësi dhe përçarje me ç'ka edhe bota muslimane filloi të nënshtrohej nga kryqëzatat e para.

Gazaliu ka shkruar për debatin dhe në fakt ai më shumë debatin e shikon si një dobësi karakteri dhe rrugë për të arritur përfitime nëse nuk i përmbahemi

1. Ziauddin Sardar, Përtej dogmës/Islami në kohët postmoderne, Logos A, Shkup, 2010, fq. 19-20.
2. Po aty, fq. 20.
3. Shiko për shembull në Kur'an er-Rrum, 31, 32; Ali Imran, 19.
4. Shiko për një libër që flet për këtë nga Taha Xhabir el-Ulvan, Kultura e dialogut në Islam, Logos A, Shkup, 2000, fq. 16 e tutje.
5. Imam Gazaliu ka jetuar gjatë viteve 450-505h/1058-1111. Për t'u njohur me jetën dhe disa ide të Imam Gazaliut në gjuhën shqipe shiko veprën Katër urtarë myslimanë nga Nexhat Ibrahimi, Logos A, Shkup. Ose në internet https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3285&h=gazaliu.
6. Për një njohje të situatës politike në kohën e Imam Gazaliut të shikohet Prof. M. Umaruddin, Koha e Gazaliut: Kushtet politike dhe fetare https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3298&h=gazaliu.

një etike.[7] Megjithatë, ai nuk e refuzon si të keqe në vete, por si e vështirë për t'ju përmbajtur etikës që na ndihmon t'i kuptojmë të vërtetat. Andaj, të shohim nëse pikëpamjet e tij do të na ndihmojnë sadopak të reflektojmë mbi etikën dhe cilësinë e debateve tona dhe ndoshta për të gjetur një rrugë më të suksesshme për t'i arritur objektivat.

Ai në veprën e tij kapitale *Ihjau ulum'd-din* shkruan se në qoftë se me anë të debatit synojmë pastrimin e fesë, ruajtjen e saj nga risitë e dëmshme dhe kërkimin e së vërtetës, atëherë debati duhet të përmbushë tetë kritere: Kriteri i parë, sipas Imam Gazaliut, që të debatohet, është që një besimtar fillimisht t'i këtë përmbushur obligimet e tij individuale , pra *fardi ajn*.[8] Ai sjell një analogji ku thotë se shembulli i atyre që merren me debate, por akoma s'kanë përmbushur obligimet e tyre parësore dhe pretendojnë se me anë të debatit duan të arrijnë tek e vërteta, është sikur të debatosh për rregullat e namazit, por në anën tjetër vetë ky person nuk e fal atë. Kriteri i dytë është që debatuesit të shohin se cilat janë nevojat jetike të shoqërive të tyre[9], e jo thjesht të vetëkënaqën nëpër salla të zbukuruara ndërkohë që jashtë atyre sallave problemet dhe sfidat e popullit behën gjithnjë e më të rënda. Atëherë vallë cilën të vërtetë po kërkojmë? Kriteri i tretë për të cilin shkruan Imam Gazaliu është që, ata që debatojnë duhet të jenë *muxhtehidë*[10], pra dijetarë që vijnë me ide dhe zgjidhje të tyre[11], e jo thjesht të polemizohet se çfarë apo si ka menduar Imam Shafiu apo Ebu Hanifja. Sigurisht në këtë kusht Imam Gazaliu ka shkruar për debatet rreth *fetva*-ve mes shkollave juridike të kohës së tij, por që, sot, ky kusht për ne nënkupton që për temat të cilat debatohet, personat që do debatojnë duhet ta njohin mirë çështjet

7. Ai madje në veprën Ihjau ulumd-din një pjesë të librit ia kushton pikërisht sëmundjeve që sjellë debati. Ai përmend dhjetë vese të dëmshme që shpesh njeriu i fiton kur debaton së tepërmi. Shiko Ihjau ulumd-din, vëll. I, Daru'l-menhegj, Xhideh, 2011, fq. 169.
8. Imam Gazaliu, po aty, fq. 159.
9. Po aty, fq. 160.
10. Po aty, fq. 162.
11. Dijetari nga Saudia Abdul Hamid A. Ebu Sulejman, i cili thotë se kriza e ummetit më shumë se sa krizë mundësish ka krizë konceptesh. Ai fajëson elitën intelektuale për shkak të distancimit të saj nga përgjegjësitë shoqërore. Si dhe krizën e stërgjatë të mendimit e ardhur si pasoj e ndryshimit politik. Shih për më shumë Abdul Hamid A. Ebu Sulejman, Kriza në mendjen muslimane, Nektari, Tiranë 2006, fq.55 e tutje.

dhe të jenë në një nivel të atillë sa ata të flasin për zgjidhje të reja që mund t'u japin problemeve fetare dhe jetës sociale në tërësi. Një kriter tjetër me shumë rëndësi është që të debatohet për ngjarjet dhe problemet aktuale.[12] Kjo ka qenë traditë që nga sahabët, ku ata gjithmonë u janë larguar debateve hipotetike[13] pa një rol kyç në përditshmërinë e tyre. Që atëherë ka thënë Gazaliu, por vazhdon të jetë dhe sot, që sot më shumë debatohen gjërat që janë atraktive apo spektakolare, shto këtu dhe kërkesat për shikueshmëri të mediave që bëjnë çmos që të zgjedhin tema "bombastike". Kriteri i pestë është që vendi i debatimit të jetë i qetë[14], në mënyrë që intelektualët të mendojnë dhe përqendrohen tek argumentet e tyre por dhe të debatuesve të tjerë. Sigurisht kjo sot është tejet e vështirë, sidomos në vende ku sallat janë të mbushura ose në rrjetet sociale ku hapen debate. Ku rendi, gjuha, niveli as që kanë rëndësi. Fundja është mënyra e të dialoguarit që tregon për nivelin dhe integrimin e vlerave të një shoqërie.[15] Imam Gazaliu thotë se kur sallat janë të mbushura me njerëz, sidomos nëse aty gjendën njerëz me pozita dhe të pushtetit, atëherë aty më shumë ka gjasa të debatohet për ndjenja e paraqitje personale se sa të arrihet qëllimi i së vërtetës. Për kohën tonë kjo duhet parë pak më ndryshe. Prezenca e pjesëve të tjera të shoqërisë mund të ndikoj që debatet të orientohen në problemet themelore. Sepse shpesh janë njerëzit jashtë ata që përballen me problemet dhe dhënia hapësirë e tyre do t'i ndihmonte intelektualët të janë më afër problemeve. Pra më shumë varet se për çfarë debatohet.

Nuk e di sa debate të tilla mund të shohim sot, por kriteri i gjashtë që vendos Gazaliu është që në debat debatuesit nuk janë armiqtë e tu, por ata janë ndihmuesit e tu.[16] Pra ne duhet të jemi aty jo thjesht për të triumfuar argumentet tona, por e vërteta. Andaj të tjerët mund dhe duhet të na vijnë në ndihmë për t'ia arritur këtij qëllimi. Nëse debati ka të bëjë me një problem, kjo do të thotë se ai problem ndikon tek të gjithë ne, atëherë ç'lidhje ka se kush arrin ta mënjanojë atë, rëndësi ka që e keqja të shmanget dhe problemet të zgjidhen. Ai sjell ngjarje të shumta se si gjenerata e parë e muslimanëve edhe ata më të diturit kanë ditur të gabojnë dhe ka ndodhur që të kenë marrë përgjigjet nga njerëz me pak të njohur, por në raste specifike përgjigjet e tyre kanë përkuar me të vërtetën që ata kërkonin. Kriteri i shtatë e që njëherësh ky kriter është bazë për çdo debat është, që debatuesve t'u jepet koha që gjithsecili të parashtrojë argumentet e tija.[17] Ai kritikon një ves që shpesh ndodh nëpër debate ku debatuesit shprehen: për këtë çështje ka argumente por nuk e shoh të arsyeshme t'i shpreh. Shpesh kemi vënë re që kur ftohen njerëz për të debatuar disa thonë: unë nuk pranoj të vij sepse është filani. Shpesh debatuesit kanë dëshirë të përballen me kandidatë sa më të papërgatitur në mënyrë që të triumfojnë. Kjo është pika e tetë ku Imam Gazaliu thotë se, që të debatohet, duhet që debatuesit të jenë të një rangu[18], me aftësi dhe përvojë pak a shumë të njëjtë. Imam Gazali ka shkruar në një tjetër vepër "*el-Kimias-seadeh*" se është pikërisht ndryshimi i shkallës së konceptueshmërisë që bën që njerëzit t'i përthellojnë mosmarrëveshjet.[19]

Media sot[20], por dhe prezenca e sa më shumë rrjeteve sociale u ka dhënë njerëzve hapësirë për më shumë debat, por ka shumë debat e aspak ndryshim. Andaj duhet të kemi kujdes për çfarë realisht po debatojmë dhe ku duam të shkojmë me gjithë këtë kohë në debate. Idetë e Imam Gazaliut nuk janë të mjaftueshme, sepse ai vetë shkruan se ka shumë më shumë se sa kaq kushte[21], por se ato na ndihmojnë për t'i pasur parasysh disa parime në orientimin dhe organizimin e debateve tona. Ajo çfarë është për të ardhur keq është sepse njerëzit mendojnë se duhet të debatojnë por realisht nuk kanë parasysh asnjë kriter apo etikë debati. Si përfundim mendoj se tre gjëra janë me rëndësi: E para ne duhet të zhvillojmë dhe orientojmë veten drejt me çështjet të cilat merremi. Cili është vizioni ynë për gjendjen që ka sjellë sistemi në dominim. Çfarë realisht duam ne? Cili është kontributi ynë për sfidat që po sjell liberalizmi; edukimi, ekonomia, drejtësia, emigrimi, ngrohja globale, pushteti teknologjik që po sfidon kaq shumë konceptet dhe sistemin demokratik? etj. E dyta të mos harrojmë se e vërteta nuk varet nga ne, sado që ne përpiqemi drejt saj dhe se duhet të dëgjojmë dhe jemi të përulur kur e vërteta del nga goja e të tjerëve. E treta, të mos harrojmë se problemet, sidomos në kohën globale, përfshijnë të gjithë, dhe krizat po prekin çdokënd, andaj kemi nevojë jo thjesht të lidhemi më shumë, por të harmonizohemi më shumë me të tjerët. Kjo është arsyeja pse kemi nevojë për një etikë debati dhe objektiva të qarta. Guximi për të pranuar dhe dëgjuar më shumë të tjerët është çështje esenciale që duhet të kihet parasysh, por që mendoj se asgjë nuk e sjell respektin e ndërsjellë nëse fillimisht nuk diskutojmë: si e kuptojmë botën para se si ta bëjmë atë. Andaj, besnikëria ndaj etikës së të Vërtetës varet nga qartësia e objektivave me të cilat synojmë të arrijmë.

05 korrik 2019, Prizren
Ripunuar 24 dhjetor 2019

12. Ihja... po aty, fq. 162.
13. Krahaso Ismail Faruki, Islamizimi i diturisë. Logos-A, Shkup, 1999, fq. 51-53.
14. Ihja... po aty, fq. 163.
15. Dijetari i madh egjiptian Muhammed el-Gazali shkruan: Islami i ka kushtuar kujdes të madh çështjes së fjalës dhe mënyrës së artikulimit të tyre, sepse fjalët që dalin nga një person, tregojnë në esencën e mendjes së tij, dhe natyrën e karakterit të tij... dhe nivelin e depërtimit të vlerave të një shoqërie. Muhammed Gazali, Morali i Muslimanit, Furkan ISM, Shkup, 2001, fq. 82.
16. Ihja... po aty, 164.
17. Po aty, fq. 166.
18. Po aty, fq. 167.
19. Imam Muhammed el-Gazali, Ilaçi i lumturisë, Gjakovë, 2000, fq. 24.
20. Për një studim rreth raportit të imamëve dhe mediave të shihet një studim i Rrezart Bekës Imamet, televizioni dhe mediat në http://erasmusi.org/imamet-televizioni-dhe-mediat/.
21. Ne duhet të kemi parasysh se kur dialogojmë apo flasim nuk po flasim vetëm për vete, pra për ata që ndjekin të njëjtën linjë mendimi dhe veprimi me ne. Porse sot duhet të jemi më të vetëdijshëm për ndryshimet e reja të kohës dhe nevoja për të zgjeruar rrethin e dialogut. Dijetari egjiptian Jusuf el-Kardavi shumë qartë e ka thënë se muslimanët shpesh kur shkruajnë apo flasin shfaqen në atë mënyrë sikur nuk ka një të dytë sikur ata. Ose edhe kur shkruajnë më në përgjithësi, ne fakt ata u drejtohen vetëm grupeve që pak a shumë mendojnë sikur ata. Prandaj ai sugjeron që sot ne kemi nevojë të tejkalojmë rrethin egocentrik të të menduarit. Ai shkruan se ne sot kemi nevojë të dialogojmë me sekularistët, pushtetarët, intelektualët perëndimorë, të krishterët, për dialog racional me orientalistët, dialog politik me perëndimin. Për më gjerë shiko Dr. Jusuf Kardavi, Detyrat parësore të lëvizjes Islame në periudhën e ardhme, Prishtinë, 2002, fq. 195-216.

Mos u trishto!

(Shkëputur nga poezia me titull "La Tahzen" – Mevlana Xhelaleddin Rumi)

Sido që të jetë problemi, shko dhe merr abdest:
Një abdest si marrfrymje,
Shtroje sixhadenë atje në dhomë diku në qoshe,
Ulu më pas dhe loto;
Nëse të vjen për mbarë, as mos bëj zë:
Zoti, brengat e tua, i di shumë më mirë se sa ti vetë.
E pra, kur t'i lutesh Atij,
Drejtoju me ndjenjat e tua më të thyera,
Sepse mëshira dhe ndiha e Zotit
Vërshon drejt plagëve të njerëzve zemërthyer.

Qëllimi i atij që e godet tapetin me shkop,
Nuk është që ta rrahë qilimin,
Por mëton veç sa pluhurin t'ia shkundë;
E atëherë, nëse Zoti yt
kërkon që të shkundë pluhur prej teje,
Përse të hakërrehesh, o shpirt?

Mos u trishto!

Në s'tu realizoftë diçka,
Kjo ndodh ose ngaqë diçka më e mirë po të vjen,
Ose ngaqë me të vërtetë është më mirë të mos ndodhë.

Kundroji zogjtë që fluturojnë,
As që mbjellin, e as që korrin diç...
Veç Zoti mendon për furnizimin e tyre me fryte,
Pra, ti tash kujton se Zoti do të të lërë pas dore?
Kurrsesi,
Mjafton që ti të dish të kërkosh prej Tij.

Nëse brengat fillojnë e gëlojnë perde-perde si shirat,
Vetëm atyre që arrijnë të mbahen fort pas Tij,
U shkruhen emrat mes ashikëve të vërtetë.
Kur kaplon e keqja, ashiku është si një varg që spikat,
E ngado që ja beh karvani i brengave,
Njeriu që ecën udhës së dashnisë,
Nuk mund të prihet dot nga e keqja.

Ndërtimi merr trajtë si fryt i passhembjes;
Grumbullimi i popullit është i lidhur pas hapërdarjes;
Rregullsia fshihet pas prishjes së rendit;
Vullneti ja beh si shkak i mungesës së dëshirës,
Ekzistenca është e fshehur në mosekzistencë...

Sa keq është kur njeriu
mbetet në pavendosmëri mes mendjes dhe zemrës;
Sa keq është kur koha ngjan aq e afert sa një çast,
Dhe njëmendësisht po aq e largët sa një shekull.
Dhe, e di çfarë?
Sa dhemb kur njeriu nuk arrin ta shprehë dot një gjë që e di,
Të mërmërisë "Unë", e të heshtë...
Të përshpërisë "Ti," e gati ta zërë e qara...

Nëse ti merr udhën e të Vërtetës,
Do të ta hapin dhe lehtësojnë rrugën;
Por nëse më mirë tretesh në ekzistencën e Vërtetë,
Atëherë do të të shndërrojnë në qenien e duhur.
Nëse arrin të shkitesh prej egos,
Do të rritesh aq shumë,
Sa as bota s'të mban
Dhe pikërisht atëhere do të ta shfaqin
veten tënde pa qënë nevoja ta shohësh vetveten...

Një sinonim tjetër i dashurisë është DURIMI:
Duron ndaj urisë dhe etjes, kjo quhet "Agjërim".
Duron ndaj dhimbjes dhe kjo emërtohet "Vendosmëri",
Bëhesh i durueshëm me njerëzit dhe kjo quhet "Tolerancë".
Duron për hir të një dëshire dhe kjo merr trajtën e "Lutjes'.
Duron për hir të ndjenjave dhe rishtas përftohet "Lotimi".
Duron ndaj mungesës së zjarrtë dhe lind "Përmallimi".
Duron ndaj pasionit dhe së fundmi kthehet në "Dashuri".

Çfarëdolloj gjëje që mund ta dua, unë e kërkoj prej Allahut.
Nëse Ai ma jep, është për nga Madhështia e Tij,
E nëse nuk ma jep, atëherë është sprovë për mua.
Nëse kërkon diçka prej Zotit:
Do të të hapen dyert;
Mjafton që ti të dish se si të trokasësh.
Se kur mund të hapet ajo derë,
nuk mund ta them, sepse nuk e di,
Por mos i humb më kot shpresat,
Veç mjafton që ti të dish gjithmonë
Si të rrish në shqem të asaj dere.

Përktheu: Mehmet Disha



BOTA JONË

| JASMIN MUXHAHID |

NGA KUSH KËRKONI NDIHMË GJATË SPROVAVE?

Nuk është e lehtë në mes shtrëngatës kur fillon shiu rrëke i shoqëruar me vetëtima e bubullima, kur retë e zeza mbulojnë diellin dhe çdo gjë që shihni janë valët e oqeanit që ju rrethojnë. Pasi nuk mund të gjeni rrugën tuaj, atëherë kërkoni ndihmë. Së pari, filloni me thirrjet e rojës bregdetare. Nuk ka përgjigje. Pastaj kërkoni ndihmë nga anijet tjera. Përsëri nuk ju dëgjojnë. Atëherë përsëri përpiqeni ta drejtoni anijen. Nuk ka dobi. Kapeni pas brezit të shpëtimit. Është i shqyer. Më në fund, pasi që i keni shfrytëzuar të gjitha mjetet, e ktheni fytyrën tuaj nga lart dhe i luteni Allahut. Pra, nuk keni më askënd për ta thirrur. Nuk ka mbetur askush nga i cili jeni të varur, pos Allahu xh.sh.

A keni pyetur ndonjëherë përse kur më së shumti u nevojiten, të gjitha dyert e krijesave janë të mbyllura?

Trokitni, por asnjëra nuk u hapet. Atëherë vraponi tek tjerat. Po ashtu i hasni të mbyllura. Pastaj shkoni nga dera në derë, trokitni, i bini fuqishëm, por askush nuk u hap derën të cilat dikur u janë hapur, por tani papritmas mbyllen. Përse? Çfarë ka ndodhur?

Shikoni, ne njerëzit i kemi disa karakteristika të cilat Allahu i madhërishëm i njeh shumë mirë. Ne vazhdimisht jemi në gjendje të nevojës. Ne jemi të dobët. Por, njëkohësisht ne jemi të ngutshëm dhe të padurueshëm. Kur jemi në fatkeqësi, ne jemi të shtyrë të kërkojmë ndihmë. Nëse është koha e bukur me diell ne nuk kërkojmë strehim. Kur kërkojmë strehim? Kur fillon fortuna, stuhia, shtrëngata. Kështu, pra Allahu xh.sh. na dërgon shtrëngatën. Ai na bën persona të nevojshëm në këto situata dhe të ngjashme në jetë, për të kërkuar strehim.

Por, ne kur kërkojmë ndihmë për shkak të mosdurimit tonë, ne e kërkojmë ndihmën në atë që e kemi afër e që duket e lehtë. E kërkojmë në atë që e shohim, e dëgjojmë dhe e prekim. Në kërkojmë rrugë të shkurtër (trup). Kërkojmë ndihmë nga krijesat duke përfshirë edhe vetveten. Ne kërkojmë ndihmë në atë që na duket më afër. A nuk është e saktë se kjo është dynjaja?

Fjala dynja d.m.th. ajo që është më e ulët, më afër. Pra, dynjaja na duket më e afërt. Por kjo është vetëm iluzion.

Ekziston diç që është më afër.

Mendoni një moment për atë që e keni më afër. Sikur t'u bënin këtë pyetje, shumica e njerëzve do të përgjigjeshin se kjo është zemra, apo mendja. Por, Allahu xh.sh. thotë:

"Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç'përshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rreh) i qafës së tij."

(Kuran, 50:16)

Në këtë verset Allahu xh.sh. na tregon se Ai i di përpjekjet tona. Është ngushëllim të dimë se dikush i sheh përpjekjet tona. Ai e di kë e thërrasim ne. Por Ai është më afër. Ai është më afër se vetë ne dhe ata që i thërrasim. Ai është më afër se damari i qafës (aorta). Por, përse damari i qafës sonë? Ç'është kjo aq bindëse tek ne? Damari i qafës është arteria kryesore që del nga zemra dhe shpërndan tërë gjakun në organizëm. Nëse pëlcet, vdekja pason menjëherë. Kjo, bukvalisht është linja e jetës sonë. Por, Allahu xh.sh. është edhe më afër se kjo. Allahu xh.sh. është më afër se jeta jonë, se vetvetja, se shpirti ynë.

Në versetin tjetër, Allahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) All-llahut dhe të të dërguarit kur ai (i dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë) dhe ta dini se All-llahu ndërhyn ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai."

(Kuran, 8:24)

Allahu xh.sh. e di që ne kemi nefs. Allahu e di që kemi zemër. Por, Allahu na thotë se Ai është bile më afër se këto gjëra. Pra, kur ne drejtohemi kah dikush tjetër pos Tij që është më i dobët, ne largohemi nga Ai. Meqë kjo është natyra jonë të cilën Allahu xh.sh. e di më së miri, Ai na mbron dhe na orienton duke na mbyllur të gjitha dyert e tjera gjatë stuhive të jetës. Ai e di se pas të gjitha dyerve të tjera të ndryshme pos derës së Tij, gjendet një greminë. Pra, këto dyer të rrejshme i mban të mbyllura për ne. Nga mëshira e Tij, Ai na dërgon stuhinë për të kërkuar ndihmë. Ai na jep provim me shumë zgjedhje, por vetëm me një opsion për ta zgjedhur përgjigjen e vërtetë. Vetë vështirësia në vete është lehtësi. Duke larguar të gjitha ndihmat e tjera, të gjitha opsionet e tjera të përgjigjes, Ai e ka bërë testin e thjeshtë. Asnjëherë nuk është lehtë me qenë në mes shtrëngatës. E në këtë është çështja. Me dërgimin e erës, Ai na gjunjëzon, e kjo është pozitë e përsosur për lutje.

Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

HAFIZ QAMIL TRESI

Tetovari që lidhi emrin e tij me Shkodrën

Hafiz Qamil Tresi u lind në Tetovë, më 06.12.1922. I biri i Abdylgafarrit dhe i Hamidijes. Babai i tij ishte Hafiz i Kur'anit, prej ku mori edhe nxitjen e parë për të vazhduar rrugën e gjatë drejt thellimit në mësimet e fesë Islame, duke filluar në prehrin e të atit, duke vijuar në medresenë e Sarajevës e duke përfunduar në rrethet e hoxhallarëve të Shkodrës, ku edhe përsosi formimin e tij si prijës fetar dhe filloi rrugën e gjatë të udhëzimit të njerëzve dhe thirrjen e tyre në Islam, deri në momentet e fundit të jetës së tij.

Pasardhësit e fisit të tij jetojnë edhe sot në Tetovë, pranë Xhamisë së Larme.

Gjuha amtare e familjes së tij ka qenë turqishtja. Për Hafiz Qamil Tresin, thuhet se ka njohur shumë mirë edhe serbishten, arabishten, osmanishten dhe shqipen, të cilën e ka perfeksionuar pas ardhjes në Shkodër.

Studimet teologjike islame i fillon në Sarajevë (ku kryen edhe hivzin e Kur'anit), por nuk arrin t'i plotësojë për shkaqe lufte.

I riu Qamil Tresi "erdhi në Shqipëri në vitin 1945 pa e mbaruar medresenë në Sarajevë". Në Shkodër, vazhdon të marrë mësime fetare në rrethin e gjerë të Myderrizit të shquar të këtij qyteti, H. Muhamed Bekteshi, të cilin e përmendte si mësuesin e tij, sipas bisedës me familjarët e Hafizit në Shkodër.

Me gjatësi mesatare, i pashëm dhe me trup të lidhur, me një mjekër të vogël e të hijshme, kryesisht me mustaqe të holla dhe çallmën me fes të zi.

Pas mbylljes së lirisë së besimit dhe praktikimit të tij, mbante një fes të zi tradicional, të cilin s'e hiqte asnjëherë nga koka, siç thonë njerëzit e tij të afërm.

"Në fillim, nga Myftinia Shkodër u emërua Imam në xhaminë Plakë, ku qëndroi pesë vjet dhe pastaj, me kërkesën e disa besimtarëve të Bërdicës, ai shkoi në Bërdicë...", ku dha një kontribut të vyer në mësimin dhe edukimin e banorëve të asaj zone me moralin dhe edukatën e besimit islam.

Hafiz Qamili do të shërbente për vite me radhë

në xhami të ndryshme të qytetit e të fshatit, deri sa do të vinte një ditë dhe stacioni i tij i fundit, në rrugën e gjatë të drejtimit të xhemateve dhe mësimit të tyre, do të ishte xhamia e lagjes "Ndocej". "Në xhaminë e lagjes "Ndocej" shërbeu afro 7 vjet, deri në vitin 1967" , kur dhuna e femohimit goditi institucionet islame dhe xhamitë e shumta të vendit tonë dhe erërat e terrorit të kuq antiislam, do të frynin furishëm mbi realitetin shqiptar, për ta tharë e për ta ngrirë atë, për ta tjetërsuar e për ta nxjerrë feje e besimi...

Hafiz Qamil Tresi konsiderohet si Imami i fundit i xhamisë së kësaj lagjeje.

Gjatë jetës së tij, ai ka arritur të krijojë një bibliotekë të pasur, me libra të shumtë e në shumë gjuhë, siç do të evidentohet më poshtë. Akoma edhe sot, pjesa dërrmuese e saj vazhdon të ruhet "me fanatizëm" dhe seriozitet nga familjarët e tij, siç pohojnë ata.

Gjatë kohës së diktaturës, biblioteka është ruajtur në shtëpi, në një raft të blerë kinse për ato libra, siç tregon njëri prej bijve të Hafizit, ndërsa pjesë të tjera të saj janë shpërndarë nëpër njerëz të besueshëm të familjes, brenda dhe jashtë qytetit.

Hafiz Qamil Tresi është martuar dy herë gjatë jetës së tij. Martesa e parë, për arsye objektive, kryesisht shëndetësore, përfundon shpejt. Martohet për herë të dytë në vitin 1960. Nga kjo martesë, ka patur shtatë fëmijë.

Duke hulumtuar në emërtimet e fëmijëve të tij, vihet re se emrat e tyre janë kryesisht me prejardhje nga gjuha arabe (gjuha e Kur'anit) dhe me kuptime të bukura e fetare, si: Muhamed– I lavdëruar, Mevahib– Dhunti të shumta, Taxhudin– Taxh i fesë, Vildan– Shumësi i fjalës fëmijë, djalë (me prejardhje Kur'anore), etj., ç'ka vërteton interesimin e tij për një edukim sa më të mirë e sa më të pastër islam të pasardhësve të tij, duke filluar që me gjetjen e një emri me kuptim e me burim, sikurse është transmetuar të ketë porositur Profeti Muhammed (a.s.).

Duke përmendur marrëdhëniet e tij me hoxhallarët e Shkodrës, gruaja e tij kujton: "Kur u martova me Hafizin, na erdhi për shyqyr edhe Hafiz Sabri begu (Bushati), se Hafizi kishte shoqëri të mirë me hoxhallarët e Shkodrës. Kishte shoqëri dhe miqësi edhe me Hafiz Sheuqet Boriçin, Hafiz Musa Dërgutin, etj., me të cilët këmbente edhe vizita të shumta".

Për këtë dëshmon edhe studimi i Dr. Feti Mehdiut, "Hafizët tanë

gjatë historisë-V", ku në listën e Myftinisë së Tetovës përmendet edhe H. Abdulgafarri, pa ndonjë të dhënë tjetër.[1]

Për këtë, i biri i Hafizit, Taxhudini thotë: "Shpesh baba thoshte se ne jemi turqeli Tetove. Madje halla e jonë, që akoma rron në Tetovë, e flet shqipen me shumë vështirësi".[2]

Në shënimet e shumta të Hafiz Qamil Tresit, janë gjetur edhe gjurmë të mësimit nga ana e tij të gjuhës gjermane, si zgjedhimi i disa foljeve, përkthimi në serbisht i disa shprehjeve të përditshme gjermane, etj. Në bibliotekën e tij ekziston edhe një ilmihal në gjuhën serbe e osmane, me shkronja të familjes arabe, një metodologji për mësimin e gjuhës frënge, një metodologji për mësimin e gjuhës perse, etj. Të gjitha këto fakte kthehen në elemente që formojnë portretin e një poligloti.

Të afërmit e Hafizit në Shkodër tregojnë se bëhet fjalë për luftën apo masakrën e Tivarit të vitit 1945, ku mesa duket edhe i riu Qamil Tresi (Abdyli) bënte pjesë në atë grup shqiptarësh, kryesisht nga trevat kosovare, që më pas u masakruan barbarisht nga ushtarët sërbo-malazezë. (Për këtë ngjarje shkruhet se me 2 prill të viti 1945, në Tivar, 3760 shqiptarë u vranë, u masakruan dhe u dogjën të gjallë nga xhelatët sërbo-malazezë).[3]

Ata pohojnë se ndërsa grupi po kalonte në Shkodër, djali i ri (Qamil Tresi) ishte futur tinëz në një dyqan për të pirë ujë dhe aty, i zoti, një tregtar shkodran i quajtur Shyqyri Behri, e kishte strehuar për disa ditë derisa jeta e tij nuk ishte më në rrezik. Familjarët e Hafizit në Shkodër, vazhdojnë ta përmendin me shumë respekt emrin e tregtarit që u bë shkak për strehimin e të dashurit të tyre dhe shpëtimin e jetës së tij![4]

Në arkivin e H. Qamil Tresit janë gjetur edhe shënime të shumta, që vërtetojnë angazhimin e tij serioz në xhaminë e fshatit Bërdicë. Ekzistojnë akoma listat me emrat e kontribuesve për mirëqenien e Imamit, akte martese të shkruara e të celebruara nga ai, etj. Ruajtja e tyre deri në këto ditë i jep atyre vlera historike, prej të cilave nxirren konkluzione për mënyrën e funksionimit të punës së Imamit në fshat dhe raporteve të tij me besimtarët.

1. Shih: Dr. Feti Mehdiu, "Hafizët tanë gjatë historisë-V", në revistën "Edukata Islame", viti XXXIV, nr. 75, Prishtinë, 2004, fq. 285.
2. Këtë fakt e ka shënuar edhe Smajl Bala në librin e tij "Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës", në faqet 554-555, ku flet për H. Qamil Tresin.
3. Për më shumë rreth kësaj tragjedie kombëtare shih: Azem Ajdini, "Masakra e Tivarit", Sh.B. "Besa", Gusht 1998.
4. Muamer Vuci, "Hafiz Qamili sakrifikoi për Islamin", në gazetën "Drita Islame", viti i III- të, nr. 16 (59), nëntor 1994, fq. 3.

THËNIE TË OSMANIT R.A.:

"Tri gjëra më janë të dashura nga dunjaja: ushqimi i të uriturit, veshja e të leckosurit dhe leximi i Kur'anit.

* * *

Ëmbëlsirën e ibadetit e kam gjetur në katër gjëra:

Në kryerjen e detyrimeve të All-llahut,

Në largimin ndaj harameve (të ndaluarave) të All-llahut,

Në urdhërimin e veprave të mira duke kërkuar shpërblimin e All-llahut,

Në largimin e njerëzve nga gjërat e shëmtuara duke u frikësuar nga hidhërimi i All-llahut.

* * *

Kur njeriu arrinë pjekurinë mendore, flet më pak.

Të folurit është zbukurim, ndërsa heshtja shpëtim

Edhe nëse flet mos e tejkalo kufirin.

Për heshtjen kurrë nuk jam penduar, ashtu siç jam penduar shumë herë, kur kam folur.

* * *



EBU HASAN SHAZILIU KËSHILLONTE:

" Nëse dëshiron të përsosësh imanin (besimin) tënd, zbukuro sjelljet e tua. Nëse dëshiron që të të dojë Allahu, merr pjesë në zgjidhjen e problemeve të njerëzve. Nëse dëshiron të jesh në radhët e larta të besimtarëve të zgjedhur, rregullisht kryej detyrimet (farzet) e Allahut. Nëse dëshiron që të takosh Allahun në Ditën e Gjykimit, duhesh të jesh tërësisht i pastërt dhe pa mëkate, atëherë rregullisht pastrohu nga ndyësia (xhunublluki) dhe pastrohu (laje tërë trupin) çdo xhuma (të premte).

Nëse dëshiron që në Ditën e Gjykimit të ringjallësh në dritë dhe i sigurt nga dënimi, mos i bëj dëm asnjë krijese të Allahut! Nëse dëshiron që të pakësohen gabimet, atëherë pandërprerë të bësh "istigfar". Nëse dëshiron të jesh njeriu më i fuqishëm, tërësisht mbështetu te Allahu. Nëse dëshiron që Allahu t'i mbulojë të metat tuaja, mbuloi të metat e të tjerëve. Nëse dëshiron që të fshihen tërësisht mëkatet tuaja, lutju pandërprerë Allahut për falje, bëhu i ruajtur, e i përulur dhe vazhdimisht bëj vepra të mira!"

ERDHI NJË NJERI TEK PEJGAMBERI ALEJHIS-SELAM DHE I THA: MË KËSHILLO, I THA PEJGAMBERI ALEJHI SELAM "KIJE FRIKË ALLAHUN KUDO QË TË JESH".
THA NJERIU: MË SHTO EDHE DIÇKA TJETËR.
PEJGAMBERI ALEJHI SELAM I THA : "PAS ÇDO PUNE TË KEQE QË VEPRON PASOJE ATË ME DIÇKA TË MIRË, SEPSE AJO SHLYEN PUNËN E KEQE."
THA NJERIU: MË SHTO ENDE.
THA PEJGAMBERI ALEJHI SELAM: "DHE SILLU ME NJERËZIT ME MORAL (EDUKATE) TË MIRË."
(TRANSMETON TIRMIDHIU (1987)

FAKTE INTERESANTE RRETH TRUPIT TË NJERIUT

"Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur" (Surja Tin : 4)

Një pjesë e lëkurës sonë ndërrohet çdo 2-4 javë duke bërë që në vit të nxirren afro 1 kg lëkurë e vdekur.

Nëse rrudhat tuaja do të përhapeshin do të arrinin masën e një këllëfi jastëku

Muskuli më i fortë i trupit tonë është gjuha dhe kocka më e fortë e trupit është nofulla.

Gjatësia totale e nervave në trupin e njeriut është 75 km

Një person prodhon rreth 600 milimetra pështymë çdo ditë.

Një person bën rreth 20 000 frymëmarrje në ditë.

Ne shpenzojmë 10 përqind të ditës duke mbyllur sytë në fraksion sekondash.

Ekzistojnë rreth 2.3 deri në 7.5 milion ngjyra sysh të ndryshme.

Pa gishtin e vogël, njeriu do të humbte 50% të fuqisë së dorës.

Zemra e njeriut rreth 100 mijë herë në ditë duke pompuar 5.5 litra gjak në minutë që i bie 3 milion litra gjak në vit.

15 – 3 deri në 5 gram të trupit tonë është i përbërë nga bakteret. Rreth 1 miliard baktere mund të rriten në secilin dhëmb.

Goja juaj prodhon rreth një litër pështymë çdo ditë.

Truri juaj është ndonjëherë më aktiv kur ju jeni në gjumë se sa kur jeni zgjuar.

Kur jemi shtrirë, enët e gjakut të një të rrituri mund të rrethojnë ekuatorin e Tokës katër herë!

Një njeri normal ka 67 lloje të ndryshme bakteresh në bark.

Organet lëshojnë një sasi të vogël të dritës që është e vështirë te shihet me sy të lirë

Ju humbisni rreth 4 kg qelizash të lëkurës çdo vit.

Dhëmbët e njeriut janë po aq të fortë sa dhëmbët e peshkaqenit.

Shkencëtarët thonë se hunda mund të nuhasë 1 trilion aroma të ndryshme.

Njerëzit janë të vetmet specie që skuqen.

Gjaku juaj përbën rreth 8% të peshës së trupit tuaj.

Kur teshtin, njeriu e bën këtë më shpejtësi mbi 160 km në orë.

Zemra e njeriu prodhon brenda një dite aq energji sa i nevojitet një kamioni për të ecur mbi 30 kilometra

Njeriu mund të jetojë pa ushqim për 70 ditë.

Receptorët e shijes nuk gjenden vetëm në gjuhë por edhe në stomak, zorrë, pankreas, mushkëri dhe në tru.

Numri i baktereve në gojën e njeriut është i barabartë me numrin e popullsisë totale të botës ose edhe më shumë.

Një fije floku mund të mbajë peshën e një molle

Dhëmbët janë pjesa e vetme e trupit që nuk mund të riparojnë veten. E gjithë kjo, për shkak se dhëmbët nuk janë pjesë "e gjallë" e trupit tonë.

Në fund të jetës së tij trupi ka prodhuar 950 kilometër flokë, ndërsa sytë janë mbyllur rreth 415 milionë herë.

"Ai i krijoi qiejt dhe tokën me të drejtë, ju formoi dhe ju dha forma të bukura. Tek Ai është kthimi"

(Tegabun.3)

I KRISHTERI QË PALOS KËPUCËT E MYSLIMANËVE NË XHAMI

Kur diversiteti tejkalon kufijtë e lajmeve të këqija dhe xhaxhai Steven është dëshmia e kësaj.

Stiven nga Singapori cdo të premte i vë vetes një detyrë të rëndësishme. Ai qëndron jashtë Xhamisë Al-Mawaddah për të palosur mjeshtërisht këpucët e besimtarëve që po falin namazin e Xhumasë.

Vepra e tij e vogël, në media sociale u bë e dashur dhe e madhe. Ai tashmë është mik me imamin Irfan Mustafa, i cili shpjegon se si Stiven, me besim të krishterë, ka një respekt të tillë për bashkëqytetarët e tij musliman.

Kur e pyetën pse e bën këtë, ai tha, "oh, thjesht ngaqë jam merakli". Komuniteti musliman në Singapor vazhdimisht shprehet mirënjohës ndaj lirisë së besimit dhe praktikimit të fesë dhe zhvillimi i hovshëm ekonomik duket se nuk po e "fëlliq" harmoninë mes njerëzve.

Një martesë e shëndetshme, një investim i çmuar

Të ruash ekuilibrin brenda familjes, të ruash shëndetin e saj është një pikë shumë e rëndësishme. Ruajtja e ekuilibrave të caktuar sigurisht që kërkon angazhimin e të gjithë anëtarëve të familjes. Ky angazhim duhet të jetë si në kohët e shëndetshme ashtu edhe në kohët e krizës në mënyrë që të ruhet struktura familjare dhe vazhdimësia e saj.

Disa periudha të rëndësishme në martesë

Periudha para martese: në këtë periudhë e cila sipas kulturës sonë quhet edhe si fejesë të dy palët bashkë me familjet e tyre përpiqen të njohin njëri tjetrin. Problemet më kryesore gjithnjë e kanë bazën në familje. Problemet ku hasin familjet e çiftit pasqyrohen edhe tek marrëdhënia e çiftit të ri. P.sh., nëse të rinjtë e sapo fejuar i përkasin kulturave të ndryshme mund të lindin vështirësi, përplasje, pakënaqësi ndërkohë që në raste të tjera kjo larmi kulturash mund të vlerësohej si diçka pozitive.

Periudha e martesës: çiftet tani fillojnë të pasqyrojnë modele të tjera sjelljeje. Ngaqë koha e kaluar së bashku është më e gjatë, fillojnë të pasqyrojnë vetveten dhe sjelljen e tyre reale. Në disa raste sjelljet e vërteta të partnerit mund të sjellin një sinqeritet më të thellë e në disa raste mund të sjellin zhgënjime të mëdha

Ardhja e një anëtari të ri në familje: një nga situatat të cilat ndikojnë më shumë në martesë është marrja e lajmit të ardhjes së një fëmije. Gjendja e ndryshueshme emocionale e femrave gjatë shtatzanisë kërkon domosdoshmërisht mbështetjen dhe ngrohtësinë e bashkëshortit. Gjatë kësaj periudhe vihet re një zgjerim në rolet e bashkëshortëve, të dy tashmë bëhen

gati të jenë prindër. Prindërit e çiftit bëhen gati të bëhen gjyshër, pra rolet ndryshojnë. Ndryshimi i roleve në disa familje bëhet burim gëzimi e kënaqësie e në disa familje të tjera shndërrohet në burim shqetësimi, ankthi e stresi. Në këta raste nëna nuk duhet lënë vetëm në muajt e parë pas sjelljes në jetë të fëmijës. Mbështetësit më të mirë mund të jenë bashkëshorti dhe nëna e saj. Të gjitha shqetësimet e përjetuara nga anëtarët e tjerë të familjes nuk duhet t'i transmetohen nënës së re sepse ndikon thellësisht në gjendjen e saj emocionale.

Rritja e fëmijëve: me rritjen e fëmijëve ndryshojnë edhe marrëdhëniet brenda familjes. Adoleshenca, kërkimi i vetevetes , problemet e brendshme, përbëjnë disa nga problemet e familjes së kësaj periudhe. Ndërkohë që fëmijët rriten dhe kërkojnë të marrin iniciativa të pavarura, ka prindër që nuk arrijnë të pranojnë rritjen e fëmijës dhe nuk i lënë të bëjnë zgjedhjet e tyre të pavarura.

Periudha e moshës së mesme: në këtë periudhë vihet re një lloj ndryshimi në marrëdhëniet brenda familjes. Njeriu fillon të shohë më shumë veten, të pyesë veten nëse është apo jo aty ku ka dashur të jetë, nëse i ka arritur apo jo qëllimet .

Pleqëria: është periudha kur fëmijët largohen nga familja, krijojnë familjet e tyre dhe bashkëshortët mbeten vetëm. Bashkë me plakjen fillojnë të pakësohen dhe fuqitë fizike, aftësitë motorike të individit.

Vdekja: vdekja të rikujton edhe një herë qëllimin e ardhjes në këtë jetë, qëllimin e ekzistencës tënde. Vdekja e njërit nga bashkëshortët ndikon më tepër tek bashkëshorti tjetër që mbetet vetëm. Në këtë rast bashkëshorti i mbetur vetëm duhet të mbështetet nga fëmijët dhe nëse nuk ka fëmijë, nga të afërmit e tij.

Çfarë duhet bërë për një investim të mirë martesor:

Lidhja: krijimi i një lidhjeje të fortë e të qëndrueshme sigurisht që mbështetet në besim e siguri. Besimi ushqen dashurinë dhe forcon lidhjen.

Vlerëso marrëdhënien: vlerëso partnerin/ en, lavdëroje, mos e kritiko, bëje të ndihet i,e dashuruar dhe ç'është më e rëndësishmja shprehe me fjalë dashurinë dhe vlerësimin tënd.

Kaloni kohë sëbashku: kalimi i kohës bashkë, zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta dhe zbavitja së bashku forcon marrëdhënien bashkëshortore.

Qëndrimi i mbajtur gjatë momenteve të krizës: mbështetja e njëri-tjetrit gjatë momenteve të vështira në jetë forcon më mirë themelin e martesës.

Mbështetja dhe stimulimi: në rastet kur njëri nga bashkëshortët nuk ndihet i mjaftueshëm, pala tjetër duhet të luajë rolin e mbështetisit, nxitësit në mënyrë që të vazhdohet përpara.

Të mbajmë rolet që na përkasin: në jetë kemi më shumë se një rol. Kur martohemi na shtohen edhe më shumë. Me kalimin e kohës mund të përballemi me një rrëmujë rolesh. Bashkëshortët duhet të sillen në përshtatje me rolet e tyre në mënyrë që të mos ketë përplasje të forta.

Të komunikosh shëndetshëm: për të realizuar një komunikim të shëndetshëm pikë së pari duhet të mësojmë të shprehim ndjenjat tona. Kjo është e domosdoshme nëse duam një martesë të konsoliduar.

RREGULLATORI I PERSONALIZUAR I TEMPERATURËS

Termostatet janë pajisje që mbajnë temperaturën në nivelin e dëshiruar. Ato përdoren në frigoriferë, pjatalarëse, furra elektrike, ngrohëse uji, makina larëse dhe në ngrohje qendrore. Pa një termostat që funksionon siç duhet, pajisjet ose makinat ka të ngjarë të prishen shumë shpejt.

A e dini se ekziston edhe një termostat në trupin tonë që vjen me një garanci të përjetshme? Po në lidhje me faktin që secili është përshtatur për secilin trup? Termostati në trupin tonë është aq i qëndrueshëm dhe i besueshëm sa që vazhdon të rregullojë temperaturën e trupit tonë përgjatë gjithë jetës, në sëmundje dhe shëndet, mot të mirë apo të keq.

Hipotermia dhe hipertermia

Kur jeni gjallë dhe aktiv, termostati juaj funksionon brenda një diapazoni të temperaturës prej një shkalle (36.5 °C - 37.5 °C). Nëse temperatura e trupit tuaj e matur në gojë është mbi ose nën këtë prag, kjo do të thotë që trupi juaj po sinjalizon probleme të caktuara. Temperaturat nën 35 °C çojnë në hipotermi, ndërsa ato mbi 39 °C shkaktojnë një problem të kundërt të quajtur hipertermia.

Hipotermia është një rënie e temperaturës se trupit, përgjithësisht për shkak të faktorëve të tillë si shiu, era, dëbora ose uji i ftohtë. Hipotermia e zgjatur së pari shkakton dridhje dhe humbje të vetëdijes dhe më pas vdekje. Nëse dikush bie në ujë të ftohtë, ai ka më tepër gjasa të vdesë më shumë nga hipotermia sesa nga mbytja.

Hipertermia, nga ana tjetër, është një gjendje në të cilën temperatura e trupit rritet në nivele të larta për shkak të faktorëve të tillë si sëmundjet inflamatore dhe ekspozimit të zgjatur në rrezet e diellit. Nëse vazhdon për një kohë të gjatë, hipertermia shkakton lodhje, marramendje, vjellje dhe probleme në presionin e gjakut. Mund të çojë në konvulsione ose vdekje, veçanërisht tek fëmijët, përveç nëse sigurohet ndihma e menjëhershme.

Ku është termostati ynë?

Pavarësisht nëse banoni në taigat siberiane ose në shkretëtirat afrikane, temperatura e trupit tuaj mbahet brenda intervalit normal. Termostati ynë, i quajtur qendra e termorregullimit, zë një vend të vogël në hipotalamusin e trurit tonë. E ngarkuar me detyrën për të balancuar temperaturën e trupit tonë, qendra aktivizohet për të ulur temperaturën kur ajo rritet dhe për ta rritur atë kur bie. Qendra përbëhet nga dy pjesë, njëra në pjesën e përparme të hipotalamusit dhe tjetra në mes. E para është përgjegjëse për uljen e temperaturës sonë, ndërsa kjo e fundit për rritjen e saj.

Janë receptorët nën lëkurën tonë që aktivizojnë qendrën. Receptorët kanë dy lloje të sensorëve të nxehtësisë, një për të ngrohtin dhe tjetri për të ftohtin.





Një ndryshim i temperaturës, madje edhe në një pikë ekstreme të trupit si gishtërinjtë, menjëherë raportohet në qendër, e cila aktivizon sistemin. Nëse temperatura e trupit duhet të bjerë, atëherë nxitet mekanizmi i djersitjes. Për ta bërë këtë, temperatura brenda trupit transferohet së pari në lëkurë. Procesi më i rëndësishëm në këtë pikë është zgjerimi i enëve të gjakut, i cili shkakton një transferim të nxehtësisë. Nëse temperatura e trupit duhet të ngrihet, enet e gjakut kontraktohen dhe shkaktohen te dridhurat.

Rregulluar për të gjitha kushtet

Termostati ynë është programuar për të shfrytëzuar maksimalisht temperaturën e trupit tonë dhe të bëjë rregullime në varësi të moshës, pavarësisht nëse jemi në gjumë, të uritur, të sëmurë dhe sipas kushteve te motit. Sasia e kërkuar e energjisë është e ndryshme për bebet, fëmijët, adoleshentët dhe të moshuarit. Trupi i njeriut ka nevojë për më pak energji gjatë gjumit dhe më shumë gjatë një sëmundjeje.

Temperatura e trupit nuk mbetet në të njëjtin nivel gjatë gjithë kohës. Temperatura e trupit tonë është unike për ne, ashtu si gjurmët e gishtërinjve dhe ajo mund të matet përmes matjeve të sakta. Faktorët që ndikojnë në temperaturën e trupit tonë mund të ndryshojë në varësi të ushqimeve që hamë, aktivitetit që bëjmë, rrobave që veshim, gjendjes shpirtërore, hormoneve tona dhe mjedisit. Rritja e temperaturës së trupit të një të rrituri për shkak të aktivitetit është më pak se ajo e foshnjave dhe fëmijëve.

Trupi ynë ka një cikël temperature që ndryshon gjatë ditës. Kur zgjohemi në mëngjes, për shembull, temperatura e trupit tonë është 0.5 gradë më e ulët se sa gjatë ditës. Ajo është në nivelin më të ulët në gjysmën e dytë të natës. Eshtë më e lartë në mes orës 16:00-18:00. Kemi shkëmbim më të madh të nxehtësisë në mot të ftohtë sesa në mot të nxehtë. Qendra e rregullimit të nxehtësisë rregullon temperaturën në përgjigje të të gjitha këtyre ndryshimeve dhe kështu kursen energji.

Temperatura jonë ndryshon edhe sipas gjinisë. Temperaturat e trupit të marra nga matjet në gojë kanë treguar se ato mund të ndryshojnë me ± 1.4 gradë tek gratë dhe me 1.2 ± tek burrat. Hormonet gjithashtu luajnë një rol në këtë ndryshim. Për shembull, gratë kanë temperatura unike të trupit gjatë periudhës dhe shtatzënisë.

Temperatura e organeve

Disa pjesë të trupit tonë dhe disa nga organet tona kërkojnë temperatura të ndryshme. Organet më të ngrohta janë në brendësi p.sh. mëlçia është 41.3 gradë mesatarisht. Lëkura është 33 gradë, dhe pjesët afër lëkurës kanë temperatura relativisht më të ulëta. Temperatura e brendshme të gojës, për shembull, është më e ulët se ajo e lëkurës. Temperaturat në sqetull dhe në vesh janë gjithashtu të ndryshme. Qendra e termorregullimit gjithashtu ka një ndikim në shkallët e reaksioneve kimike që ndodhin në nivelin qelizor, pasi mban secilin nga organet që punojnë në temperatura optimale.

Ka një mençuri të jashtëzakonshme në atë se si trupi ynë nxehet (ose jo). Pjesët e trupit që bashkëveprojnë me botën e jashtme kanë temperaturë më të ulët. Një nga avantazhet e kësaj është se mban konsumin optimal të energjisë. Sa më i lartë të jetë ndryshimi i temperaturës midis dy objekteve, aq më lehtë është shkëmbimi i nxehtësisë. Nëse lëkura jonë do të ishte aq e ngrohtë sa temperatura jonë mesatare, d.m.th. 37 °C, do të humbnim më shumë nxehtësi në ritme më të larta.

Për më tepër, sytë tanë kanë një mekanizëm shumë të veçantë. Sytë, gati 90% e të cilëve janë ujë dhe sipërfaqja e të cilëve duhet të jetë e lagësht, janë në kontakt të vazhdueshëm me botën e jashtme. Sidoqoftë, sytë

e njerëzve që jetojnë në klimë të ftohtë, ku temperatura mund të arrijë -50 °C, nuk ngrijnë sepse sytë vendosen në një strehë mbrojtëse dhe mbështillen nga muskuj, shtresa dhjami dhe qepallat. Për më tepër, kapilarët, që janë zgjatje të arterieve okulare që rrethojnë sytë si një rrjetë, mbajnë rregullisht gjak të ngrohtë në sy. Për më tepër, fakti që lotët janë të kripur, ul pikën e ngrirjes së tyre.

Bilanci i temperaturës në gjallesat e tjera

Kafshët gjithashtu kanë temperatura trupore të programuara në mënyrë ideale për funksionet e tyre. Iriqi, për shembull, ka një temperaturë trupi prej 36 °C, por që bie në 6 °C gjatë letargjise dimërore. Temperaturat e trupit të shumicës së gjitarëve mbahen rreth 37 °C.

Kafshët gjithashtu janë të pajisura me sisteme të cikleve të temperaturës siç kërkohet nga kushtet klimatike dhe mjedisore në të cilat ata jetojnë. Për shembull, temperatura e trupit të oriksit, një antilopë afrikane, mund të rritet në 45 °C kur është në arrati. Ai mund të përballojë një temperaturë kaq vdekjeprurëse falë sistemit të përsosur që mbron trurin e tij. Oriksi ka një rrjet të veçantë enësh në anën e poshtme të trurit i cili ul temperaturën e trupit për shkak të humbjes së nxehtësisë të shkaktuar nga avullimi. Arteria karotide ndahet në venat më të vogla në zgavrën e sinusit përpara se të dërgojë gjakun në tru, gjë që bën që gjaku të humbasë nxehtësinë. Kur gjaku arrin në tru, tashmë është mjaft i ftohtë që truri të funksionojë siç duhet.

Krijimi i sistemeve të tilla sigurisht që është i mrekullueshëm dhe megjithatë ne kurrë nuk mendojmë për to. Të gjitha nevojat tona përmbushen pa e ditur këtë gjë.

Erion Sukaj

Dhurata e sinqertë

Një herë një njeri shkoi për vizitë te miku i tij. Qëndroi për njëfarë kohe dhe u prit shumë mirë. Kur erdhi koha e ndarjes, miku ia dhuroi një kalë.

Ky u mahnit nga bujaria e mikut dhe ashtu i lumtur u largua. Pas dhjetë ditësh njeriu u kthye me kalë. Edhe kësaj radhe miku e priti ngrohtë, por në fund e pyeti:

- Çfarë ndodhi?

- Nuk e di, iu përgjigj njeriu. Dëshiroja të shkoja në qytet, por kali më solli këtu.

- Në rregull, i tha miku. Ky kalë ka lindur dhe është ushqyer në këtë fshat. Ai është lidhur me gjërat e mia dhe me stallën e tij. E kuptoj këtë, por mos harro se unë ta kam dhuruar ty dhe tashmë të takon ty.

Pas dy ditësh, njeriu bashkë me kalë u largua nga fshati.

Kaluan dhjetë ditë të tjera dhe papritur njeriu u paraqit përsëri në shtëpinë e mikut të tij. Përsëri u prit me ngrohtësi, dhe në fund miku e pyeti me butësi:

- Çfarë ndodhi këtë herë?

- E njëjta gjë, tha njeriu. Kali përsëri më ktheu te ti!

Por, kësaj radhe miku i tha:

- Unë do të mësoj se si duhesh të sillesh me kalin.

Kështu njeriu mësoi gjërat më kryesore se si duhej të sillej me kalin. Pas kësaj, njeriu shkoi dhe nuk u kthye më. Bashkëshortja kureshtare e pyeti bashkëshortin:

- Cili është roli yt në tërë këtë?

- Mund t'i japësh dikujt një dhuratë, por kjo nuk do të thotë se ai duhet ta keqpërdorë atë. Obligimi ynë është që të dimë se si ta shfrytëzojmë dhuratën, i tha burri.

Në të njëjtën mënyrë Allahu i dashur ua dhuron njerëzve mendjen, zemrën, veshët, sytë dhe të mira tjera, por ata nuk dinë gjithmonë t'i shfrytëzojnë si duhet. Prandaj Ai, përveç dhuntisë, ka marrë edhe përgjegjësinë që t'i mësojë njerëzit se si t'i shfrytëzojnë dhuratat e Tij, duke i mësuar se si duhet të udhëheqin me "kalin"-nefsin e tyre, në mënyrë që ai mos t'i kthej pas në shkatërrim. Prandaj, kur ne t'i dhurojmë dikujt diçka, duhet të kemi durim, vendosmëri, dashuri dhe butësi që t'ia tregojmë atij të gjitha bukuritë e dhuratës. Për këtë, mësuesit e sinqertë janë të shquar për butësinë dhe dashurinë ndaj njerëzve. Pra, mësuesi duhet ta mësojë nxënësin, për hir të Allahut, e jo për ndonjë dobi tjetër. Tregimi për dhuratën në mënyrë të bukur e tregon dashurinë e mësuesit ndaj nxënësit, gjegjësisht për butësinë që personi në pozitë më të lartë duhet të ketë ndaj personit në pozitë më të ulët.

Një buqetë me lule për nënën

Një burrë ndaloi në një dyqan lulesh për të porositur disa lule që t'ia dërgonte me postë nënës së tij e cila jetonte 200 milje larg.

Ndërsa po dilte nga makina vuri re një vajzë të vogël që ishte ulur buzë trotuarit duke qarë me dënesë.

Ai e pyeti atë se çfarë nuk shkonte siç duhej dhe ajo iu përgjigj, "Dëshiroja të blija një trëndafil të kuq për nënën time. Por, kam vetëm 75 cent, dhe një trëndafil kushton 2 dollarë."

Burri buzëqeshi dhe i tha, "Eja me mua. Do të ta blej unë një trëndafil." Ai i bleu vajzës së vogël trëndafilin e saj dhe porositi lulet për nënën e tij.

Teksa po largoheshin ai i ofroi vajzës ta shoqëronte deri në shtëpi. Ajo i tha, "Po të lutem! Mund të më dërgosh te nëna ime."

Ajo e drejtoi burrin deri te varrezat, ku vendosi trëndafilin e saj në një varr të gërmuar kohët e fundit.

Burri u kthye në dyqanin e luleve, anuloi dërgimin me postë, zgjodhi një buqetë të madhe dhe udhëtoi 200 milje deri në shtëpinë e nënës së tij.

“NJERIU ASNJËHERË NUK MUND TË PENDOHET NGA ADHURIMI NDAJ ALLAHUT XH.SH, E AS QË HUMB KOHË KUR U BINDET NDALESAVE TË TIJ, E AS QË POSHTËROHET KUR ME DEVOTSHMËRI E ZBUKURON VETEN.”

MUHAMED EL-GAZALI

RADIO SPEKTRUM
VJEN PËR DËGJUESIT
ME NJË PROGRAMACION
TË PASUR ME TEMATIKA
FETARE, SOCIALE, KULTURORE,
EDUKATIVE DHE INFORMUESE
RADIO
SPEKTRUM
FREKUENCA E
DUHUR
96.4 FM
SPEKTRUM
FREKUENCA E DUHUR
www.spektrum.al

“DRITA ISLAME” ËSHTË E TË GJITHËVE.
NDIHMO QË TË RREZATOJË ME NDRIÇIMIN E SAJ TË VËRTETË.

REVISTA SHKENCORE “ZANI I NALTË” ËSHTË NJË DRITARE E HAPUR E BOTËS AKADEMIKE SHQIPTARE DHE NDËRKOMBËTARE.

ABONOHU PËR VITIN 2020

“DRITA ISLAME” VETËM PËR 1200 LEKË
“ZANI I NALTË” VETËM PËR 800 LEKË

Kontakt: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë
Tel/fax: + 355 4 22 30 492 | Cel: 067 29 47 096
e-mail: dritaislame@kmsh.al | www.dritaislame.al
Për më tepër kontaktoni pranë myftinisë së rrethit tuaj, medreseve, ose pranë xhamisë më të afërt.